

INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SH.A.

Pasqyrat Financiare më

31 Dhjetor 2014

(me raportin e audituesve të pavarur)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i audituesve të pavarur	i-ii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave përmbledhëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3-4
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare	5
Shënime shoqëruese mbi Pasqyrat Financiare	
1. Subjekti Raportues	6
2. Bazat e përgatitjes	6
3. Përmbledhje e politikave kontabël	7-18
4. Menaxhimi i riskut financiar	19-36
5. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël	37-38
6. Aktivitetet dhe detyrimet financiare	39-40
7. Mjete monetare dhe të ngjashme	41
8. Hua dhe paradhënie bankave	41
9. Letra me vlerë të vendosjes	41
10. Letra me vlerë të investimit	42
11. Hua dhe paradhënie klientëve	42
12. Ndërtesa dhe pajisje	43-44
13. Aktive afatgjata jo-materiale	45
14. Mjete të tjera	46
15. Detyrime ndaj bankave	47
16. Detyrime ndaj klientëve	48-49
17. Tatimi i shtyrë	49-50
18. Provizione	50
19. Detyrime të tjera	51
20. Kapitali aksionar dhe primit	51
21. Rezerva ligjore dhe rregullative	52
22. Rezerva të tjera vlerësimi	52
23. Të ardhura nga interesi, neto	53
24. Të ardhura nga komisioni, neto	53
25. Të ardhura bankare nga tregtueshmëria, neto	54
26. Të ardhura / (shpenzime) të tjera operative, neto	54
27. Shpenzime personeli	54
28. Shpenzime të tjera	54
29. Shpenzime tatimi mbi fitimin	55-56
30. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	56-57
31. Angazhime qiraje dhe shpenzime qiraje operacionale	57
32. Palët e lidhura	57-58
33. Ngjarje pas datës së bilancit	59



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Aksionerëve të
Intesa Sanpaolo Albania Sh.a.

Tiranë, 2 Shkurt 2015

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Intesa Sanpaolo Albania Sh.a. ("Banka"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2014, pasqyrat e fitim humbjeve dhe të ardhurave përmbledhëse të tjera, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve


Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Bankës më 31 dhjetor 2014, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.



Steven Nutley
Partner

KPMG Albania Sh.p.k.
“Deshmoret e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.

Pasqyra e pozicionit financiar

Më 31 Dhjetor 2014

(në mijë Lek)

	Shënime	2014	2013
Aktivët			
Mjete monetare dhe të ngjashme	7	15,890,476	12,466,255
Hua dhe paradhënie bankave	8	25,343,535	21,027,977
Letra me vlerë të vendosjes	9	3,969,543	2,363,630
Letra me vlerë të investimit	10	57,309,439	56,162,536
Hua dhe paradhënie klientëve	11	40,341,394	43,431,412
Ndërtesa dhe pajisje	12	1,398,437	1,454,468
Aktive afatgjata jo-materiale	13	554,635	449,216
Të drejta tatimore të shtyra	17	76,962	75,174
Të drejta tatimore afatshkurtra		507,139	508,867
Mjete të tjera	14	2,642,524	1,298,252
Aktive gjithsej		148,034,084	139,237,787
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	15	5,663,139	5,264,048
Detyrime ndaj klientëve	16	121,279,675	114,700,816
Llogari rrjedhëse		40,636,690	31,784,246
Depozita me afat		80,642,985	82,916,570
Detyrimet tatimore afatshkurtër		300,272	-
Provizione	18	431,973	511,766
Detyrime të tjera	19	1,075,398	761,645
Detyrime gjithsej		128,750,457	121,238,275
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	20	5,562,518	5,562,518
Primet e aksioneve	20	1,383,880	1,383,880
Rezerva ligjore dhe rregullative	21	1,744,615	1,695,524
Rezerva për vlerën e drejtë	22	99,569	70,976
Rezerva e rivlerësimit nga kurset e këmbimit	22	(11,077)	2,865
Zëra të tjerë përmbledhës	22	714,555	714,555
Fitimi i paspërndarë		9,789,567	8,569,194
Totali i Kapitalit Aksionar		19,283,627	17,999,512
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksionar		148,034,084	139,237,787

Shënimet nga faqja 6 deri në 59 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.

Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse

Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014*(në mijë Lek)*

	Shënime	2014	2013
Të ardhura nga interesat		6,687,516	7,949,553
Shpenzime për interesat		(2,233,639)	(3,116,189)
Të ardhura nga interesi, neto	23	4,453,877	4,833,364
Të ardhura nga komisionet		741,342	740,464
Shpenzime për komisionet		(137,047)	(110,117)
Të ardhura nga komisionet, neto	24	604,295	630,347
Të ardhura të tjera, neto	25	439,718	583,938
Shpenzime të tjera operative, neto	26	(244,587)	(213,908)
Të ardhura operative		5,253,303	5,833,741
Humbje nga zhvlerësimi i mjeteve financiare, neto	11	(572,419)	(2,503,065)
Humbje nga zhvlerësimi i zërave jashtë bilancit	18	(7,259)	(2,150)
Zhvlerësimi i mjeteve të tjera		(145,376)	-
Shpenzime personeli	27	(1,033,426)	(989,528)
Shpenzime operacionale qiraje	31	(163,839)	(162,421)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(316,539)	(283,617)
Amortizimi i përmirësimeve të ambienteve me qira	14	(11,122)	(14,577)
Shpenzime të tjera administrative	28	(613,541)	(658,984)
Provizione për rreziqe dhe shpenzime	18	94,034	-
Totali i shpenzimeve		(2,769,487)	(4,614,342)
Fitimi neto para tatimit		2,483,816	1,219,399
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	29	(428,899)	(237,582)
Fitimi për periudhën		2,054,917	981,817
Të ardhura të tjera përmbledhëse		-	-
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes		28,593	111,600
Diferenca valutore e rivlerësimit		(13,942)	(1,065)
Efeki i tatimit mbi fitimin		-	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse për periudhën, neto		14,651	110,535
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën, neto		2,069,568	1,092,352

Shënimet nga faqja 6 deri në 59 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.

Pasqyra financiare e ndryshimeve në kapital

Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014*(në mijë Lek)*

	Kapitali aksioner	Primet e aksioneve	Rezerva ligjore dhe rregullative	Rezerva për vlerën e drejtë	Rezerva e rivlerësimit nga kurset e këmbimit	Zëra të tjerë përmbledhës	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 Janar 2013	5,562,518	1,383,880	1,655,632	(40,624)	3,931	714,555	7,627,269	16,907,161
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	-	981,817	981,817
Të ardhura të tjera përmbledhëse								
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes	-	-	-	111,600	-	-	-	111,600
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse	-	-	-	111,600	-	-	-	111,600
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin	-	-	-	111,600	-	-	981,817	1,093,417
Transaksione me aksionerët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar								
Përvetësimi i fitimit të mbartur	-	-	39,892	-	-	-	(39,892)	-
Diferenca valutore e rivlerësimit	-	-	-	-	(1,066)	-	-	(1,066)
Totali i kontributeve sipas shpërndarjes tek aksionerët	-	-	39,892	-	(1,066)	-	(39,892)	(1,066)
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	5,562,518	1,383,880	1,695,524	70,976	2,865	714,555	8,569,194	17,999,512

Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.

Pasqyra financiare e ndryshimeve në kapital (vazhdim)

Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(në mijë Lek)

	Kapitali aksioner	Primet e aksioneve	Rezerva ligjore dhe rregullative	Rezerva për vlerën e drejtë	Rezerva e rivlerësimit nga kurset e këmbimit	Zëra të tjerë përmbledhës	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 Janar 2014	5,562,518	1,383,880	1,695,524	70,976	2,865	714,555	8,569,194	17,999,512
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	-	2,054,917	2,054,917
Të ardhura të tjera përmbledhëse								
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes	-	-	-	28,593	-	-	-	28,593
Vlera neto e klasifikuar në ndryshimin e fitimit dhe humbjes në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse	-	-	-	28,593	-	-	-	28,593
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin	-	-	-	28,593	-	-	2,054,917	2,083,510
Transaksione me aksionerët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar								
Përvetësimi i fitimit të mbartur	-	-	49,091	-	-	-	(49,091)	-
Dividentët për aksionarët	-	-	-	-	-	-	(785,453)	(785,453)
Diferenca valutore e rivlerësimit	-	-	-	-	(13,942)	-	-	(13,942)
Totali i kontributeve sipas shpërndarjes tek aksionerët	-	-	49,091	-	(13,942)	-	(834,544)	(799,396)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	5,562,518	1,383,880	1,744,615	99,569	(11,077)	714,555	9,789,567	19,283,627

Shënimet nga faqja 6 deri në 59 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare****Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

(në mijë Lek)


	2014	2013
Fluksi i parasë nga aktivitet operative		
Fitimi i periudhës	2,054,917	981,817
Rregullime për të rakorduar ndryshimin në aktivet neto me mjetet monetare neto të siguruara nga aktivitet operative:		
Zhvlerësimi i ndërtesave dhe paisjeve	327,661	298,194
Nxjerrja jashtë përdorimit e ndërtesave dhe paisjeve	14,312	3,156
Amortizimi i investimeve financiare	71,673	(53,101)
Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare	145,376	-
Humbja nga zhvlerësimi i investimeve në letra me vlerë	-	(858)
Humbja nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënies për klientët	572,419	2,503,923
Humbja nga zhvlerësimi i aktivitetëve të tjera financiare	7,259	2,150
Ndryshime në interesin për t'u arkëtuar	(132,451)	(119,813)
Ndryshime në interesin për t'u paguar	(335,951)	(111,519)
Diferenca nga ndryshimi i kursit të kembimit	(13,942)	(1,065)
Ndryshime në aktive dhe detyrime operative	656,358	2,521,067
Ndryshime në hua dhe paradhënie bankare	(4,350,542)	(7,693,237)
Ndryshime në hua dhe paradhënie klienteve	2,654,042	(1,713,335)
Ndryshime në aktive të tjera	(1,069,151)	(521,001)
Ndryshime në detyrime ndaj bankave	399,645	1,592,912
Ndryshime në detyrime ndaj klientëve	6,915,429	7,383,486
Ndryshime në detyrime të tjera dhe provizione	266,701	(62,848)
Tatimi fitimi i paguar	(131,407)	(374,377)
Fluksi neto i parasë nga/ (përdorur në) aktivitet operative	4,681,715	1,132,667
Fluksi i parasë nga aktivitet investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	(230,167)	(299,662)
Blerja e ndërtesave dhe paisjeve	(150,074)	(230,466)
Të ardhura nga shitja e ndërtesave dhe paisjeve	-	211
Blerja e investimeve financiare	(2,803,075)	(4,845,000)
Fluksi neto i parasë përdorur nga aktivitetet investuese	(3,183,312)	(5,374,917)
Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese		
Kthimi i borxhit të varur	-	(530,442)
Dividenti i paguar	(785,454)	-
Fluksi neto i parase nga aktivitetet e financimit	(785,454)	(530,442)
(Rritja/Rënia) neto e mjeteve monetare gjate periudhes	3,424,221	(3,790,875)
Mjete monetare e te ngjashme me to ne fillim te periudhes	12,466,255	16,257,130
Mjete monetare e të ngjashme në fund të periudhës	15,890,476	12,466,255
Fluksi i parasë operative nga interesat		
Interesa të paguara	2,569,655	3,225,738
Interesa të arketuara	6,935,378	7,776,639

Shënimet nga faqja 6 deri në 59 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë firmosur në emër të Bankës më 02 shkurt 2015, nga:



Silvio Pedrazzi
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



Vincenzo Petraroli
Drejtor i Kontabilitetit dhe Taksave

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

1. Subjekti raportues

Intesa Sanpaolo Bank Albania, (më poshtë referuar “Banka”), themeluar në Maj të vitit 1998, u autorizua që të ushtronte aktivitet bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin nr. 8365, “Për Sistemin Bankar në Shqipëri”, datë 2 Korrik 1998, i cili u zëvendësua nga ligji nr. 9662 “Për Bankat në Shqipëri”, datë 18 Dhjetor 2006, i cili hyri në fuqi në Qershor 2007. Banka e filloi aktivitetin e vet më 24 Shtator 1998.

Banka, me seli në Tiranë, në adresën Rruga “Ismail Qemali”, nr. 27, ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet një rrjeti të përbërë nga 32 degë dhe agjenci në qytete të ndryshme të Shqipërisë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Fier, Berat, Gjirokastrë, Korçë, Lushnje, Shkodër, Lezhe, Lavaje etj. (2013: 31 degë dhe agjenci).

Në 31 Dhjetor 2014 Banka numëronte 569 punonjës (2013: 536).

Pas marrjes së miratimit përfundimtar të Bankës së Shqipërisë, duke filluar nga data 13 Tetor 2008 emri i Bankës u ndryshua nga Banka Amerikane e Shqipërisë në Intesa Sanpaolo Bank Albania.

2. Bazat e Përgatitjes

(a) Deklaratë për përputhshmërinë rregullative

Në përputhje me legjislacionin kontabël vendas, pasqyrat financiare janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të vendosura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me parimin e kostos historike, duke bërë përjashtim vetëm për mjetet financiare të letrave me vlerë të vendosjes, të cilat janë të matura me vlerën e drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të raportuara në Lek, e cila është në të njëjtën kohë edhe monedha funksionale e Bankës. Me përjashtim të rasteve kur është specifikisht e shprehur, informacioni financiar i shprehur në Lek është rrumbullakosur në të mjtën më të afërt.

(d) Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykimet, çmuarjet dhe supozimet të cilat prekin zbatimin e politikave kontabël dhe vlerat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet në fjalë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën gjatë të cilës rishikohen çmuarjet si dhe në periudha të tjera në të ardhmen. Informacioni për aspekte të rëndësishme të pasigurive të çmuarjeve dhe gjykimet e rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të madh në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të përfshira tek shënimi 5.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë periudhën e pasqyrave financiare si dhe janë aplikuar vazhdimisht nga Banka.

(a) Monedha e huaj

Transaksionet e këmbimeve valutore janë kthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë këmbyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e këmbimit. Fitimi ose humbja nga këmbimet valutore të zërave monetar është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit të ditës në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Instrumentet jo-monetare të cilat janë matur në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Megjithatë, diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga rikonvertimet njihen në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhese. Diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga këmbimet valutore me aksionaret regjistruhen direkt në kapitalin aksioner.

(b) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet me njohjen fillestare të aktivitetit dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas. Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet, dhe zbritjet ose primet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes së një aktivi ose detyrimi financiar.

(c) Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar përfshihen në përcaktimin e normës efektive të interesit. Të ardhurat e tjera nga komisionet, përfshirë komisionet e shërbimit, komisionet për menaxhim investimi, komisionet për shitje dhe vendosje depozite njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve. Shpenzime të tjera nga komisionet lidhen kryesisht me komisionet për transaksione dhe shërbime, të cilat kalojnë në shpenzime në momentin e marrjes së shërbimit të ofruar.

(d) Të ardhura bankare nga tregtueshmëria, neto

Të ardhura bankare nga tregtueshmëria, neto përfshijnë fitimin minus humbjet që rezultojnë nga tregtimi i aktiveve dhe detyrimeve, dhe përfshijnë të gjitha ndryshimet e vlerës së drejtë dhe diferencat e këmbimeve valutore.

(e) Të ardhura nga dividendët

Të ardhurat nga dividendët njihen kur vendoset e drejta për të përfituar të ardhura. Zakonisht, kjo bëhet në datën e ish-dividendit për letrat me vlerë të kapitalit. Dividendët pasqyrohen si komponent i të ardhurave bankare neto nga tregtueshmëria, të ardhurave neto nga instrumente të tjera financiare të matura me vlerën e drejtë ose të ardhurave të tjera operative, në bazë të klasifikimit themelor të instrumentit të kapitalit.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(f) Qiraja dhe përmirësimet e ambienteve me qira – Banka si qiramarrëse

Përcaktimi nëse një marrëveshje është kontratë qiraje ose përmban një të tillë, bazohet në thelbin dhe përmbajtjen e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim të faktit nëse përmbushja e detyrimeve të marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve të veçantë dhe nëse në marrëveshje parashikohet e drejta për përdorimin e aktivitetit. Banka ka vetëm marrëveshje qiraje operacionale, pagesat e të cilave njihen në pasqyrën e të ardhurave me metodën lineare gjatë gjithë kohëzgjatjes së qirasë.

Shpenzimet për përmirësimin e ambienteve që përdoren në bazë të këtyre marrëveshjeve kontabilizohen si mjete të tjera dhe amortizohen në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Pagesat rastësore për qiratë kontabilizohen me anë të rishikimit të pagesave minimale të qirasë për periudhën e mbetur në momentin e konfirmimit të ndryshimit të kontratës së qirasë.

(g) Shpenzime për tatimet

Shpenzimet për tatimet përfshijnë tatimin afatshkurtër dhe tatimin e shtyrë. Tatimi afatshkurtër dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim kur i referohet zërave të cilët njihen direkt në kapital ose tek të ardhurat e tjera përmbledhëse.

(i) Tatimi afatshkurtër

Tatimi afatshkurtër është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose shpenzimet për periudhën, duke përdorur normat e taksave në fuqi ose të cilat hyjnë në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet në lidhje me vitet e mëparshme. Tatimi afatshkurtër i pagueshëm përfshin gjithashtu çdo detyrim tatimor që lind nga deklarimi i dividendëve.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë përlogaritet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të të drejtave dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimi. Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që ndjekin mënyrën sipas të cilës Banka parashikon, në fund të periudhës së raportimit, të rikuperojë ose likuidojë vlerën e mbartur të të drejtave dhe detyrimeve të saj. Tatimi i shtyrë matet me normat e taksave të cilat janë parashikuar të zbatohen mbi diferencat e përkohshme në momentin e kthimit të tyre, duke përdorur normat e taksave në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit. Të drejtat dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen me njëra-tjetrën, nëse një e drejtë e detyrueshme ligjore ekziston për të kompensuar një të drejtë tatimore afatshkurtër kundrejt një detyrimi tatimor afatshkurtër dhe tatimet e shtyra lidhen me të njëjtët subjekte të tatueshëm dhe autoritet tatimor, ose me subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë si qëllim të likuidojnë detyrimet dhe të drejtat tatimore afatshkurtra neto ose të drejtat dhe detyrimet e tyre tatimore do të realizohen njëkohësisht. Tatimet shtesë që lindin nga shpërndarja e dividendëve nga Banka njihen në të njëjtën kohë që njihet detyrimi për të paguar dividendin përkatës.

E drejta tatimore e shtyrë njihet për humbjet e papërdorura tatimore, kreditimet tatimore dhe diferencat tatimore të zbritshme deri në atë nivel ku është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të materializohet. Të drejtat tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në atë nivel që nuk ka më mundësi që të realizohet fitimi nga tatimet.

(iii) Ekspozimi tatimor

Për përcaktimin e vlerës së tatimit afatshkurtër dhe të shtyrë, Banka merr në konsideratë ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse duhet të paguhet tatime shtesë dhe interesa. Ky vlerësim mbështetet në çmuarjet dhe supozimet dhe mund të përfshijnë një sërë gjykimesh për ngjarje në të ardhmen. Të dhëna të reja mund të bëhen të disponueshme, si rezultat i të cilave Banka të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime të detyrimeve tatimore do të prekin dhe shpenzimin për tatimet për periudhën gjatë të cilës bëhet përcaktimi.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(h) Aktivët dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet, depozitat dhe huamarrjet në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur banka angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivitetit. Të gjitha aktivët dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit. Aktivi ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për një instrument që nuk matet me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes e, kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes ose emetimit të tij.

(ii) Klasifikimi

Aktivët financiare

Banka klasifikon aktivët e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe të arkëtueshme;
- Letra me vlere te investimit; ose
- Letra me vlere te vendosjes

Shikoni shënimet 3 (i), (j) dhe (k).

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, ndryshe nga garancitë financiare dhe angazhimet e huas, si të matura me koston e amortizuar.

Shikoni shënimet 3 (o), (p) dhe (q).

(iii) Mos-njohja

Aktivët financiare

Banka nuk e njeh më një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Çdo interes në aktivët financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete. Banka nuk njeh një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë shfuqizuar, anuluar ose kur u skadon afati.

Banka kryen transaksione nëpërmjet të cilave transferon aktivët e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e aktiveve të transferuara, apo ndonjë pjesë të tyre. Në rast se Banka merr përsipër të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet, atëherë aktivët e transferuara vazhdojnë të njihen në bilancin kontabël. Transferimi i aktiveve, ndërkohë që merren përsipër të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet përfshijnë për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes.

Për transaksionet ku Banka nuk mban dhe as transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme që rrjedhin nga pronësia mbi aktivin financiar, ajo nuk e njeh aktivin në rast se nuk ka kontroll mbi aktivin. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen gjatë transferimit njihen më vete si aktive dhe detyrime, sipas rastit. Në transferime, ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin për aq kohë sa ky aktiv rezulton i përfshirë, e cila përcaktohet nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar.

Banka fshin kredi të caktuara të cilat përcaktohen si kredi të pakthyeshme. Rimarrja e një zëri të fshirë nga bilanci regjistrohet nën zërin Të ardhura/shpenzime të tjera operative në pasqyrën e të ardhurave (shih shënimin 26).

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(h) Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Detyrimet financiare

Banka nuk njih një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë shfuqizuar, anuluar ose kur u skadon afati

(iv) Kompensimi

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose për fitime apo humbje të cilat rezultojnë nga realizimi i transaksioneve të ngjashme në aktivitetin tregtar të Bankës.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e aktivitetit ose detyrimit financiar përbën shumën me të cilën aktivi dhe detyrimi financiar matet në fazën e njohjes fillestare, minus kthimin e principalit, plus ose minus vlerën e amortizimit të akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për të gjitha ndryshimet midis shumës fillestare që është njohur dhe shumës së maturuar, duke zbritur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(vi) Matja me vlerën e drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e kuotuar në treg ose çmimet e kuotuar nga agjenti për instrumentet financiare të cilat tregtohen në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentet e tjerë financiare vlera e drejtë përcaktohet me anë të teknikave të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë metodën e vlerës aktuale neto, metodën e zbritjes së fluksit të mjeteve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat në treg ekzistojnë çmimet përkatëse, dhe modelet e vlerësimit. Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare të zakonshme dhe të thjeshta si opsionet dhe kontratat "swap" të normave të interesit dhe këmbimeve valutore. Për këto instrumente financiare informacionet që përdoren në modele janë të evidentueshme në treg.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ekzistojnë fakte objektive që aktivët financiarë të cilat nuk janë mbajtur me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave janë të zhvlerësuar. Aktivët financiarë ose një grup i aktiveve financiare zhvlerësohet më vete kur faktet objektive ose kriteret e gjykimit tregojnë që një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit (aktiveve), dhe që kjo ngjarje humbjeje ka një impakt në flukset e ardhshme të parasë nga ky mjet (mjete) që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Faktet objektive që aktivët janë zhvlerësuar mund të përfshijnë vështirësi të konsiderueshme financiare të huamarrësit ose emetuesit, mospërmbushje e detyrimeve ose shkelje e detyrimeve nga huamarrësi në lidhje me pagesat e interesit dhe të principalit, ristrukturimin e një huaje ose paradhënie nga Banka për shkak të vështirësive financiare të klientit dhe me kushte që Banka nuk mund të shqyrtojë ndryshe, tregues që një huamarrës ose emetues do të falimentojë, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të njohura në nivel kombëtar ose lokal në lidhje me një grup aktivesh si ndryshimet jo të favorshme në statusin e pagesës së huamarrësve dhe ose emetuesve në grup, ose kushtet ekonomike të cilat lidhen me mospërmbushjen e detyrimeve në grup, apo një rënie e matshme të parashikimit të rrjedhës së parave që pritet nga një grup i aktiveve financiare që nga momenti i njohjes fillestare të këtyre aktiveve. Banka merr në konsideratë treguesit për zhvlerësimin e huave dhe paradhënieve dhe të investimeve në letra me vlerë të vendosjes në nivelin e një aktivi të vetëm dhe kolektivisht. Të gjitha aktivët financiarë të rëndësishme, huatë, paradhëniet dhe investimet në letra me vlerë të vendosjes, vlerësohen veçmas për zhvlerësime specifike.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(h) Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve (vazhdim)

Aktivët financiarë të cilat nuk rezultojnë të zhvlerësuar në veçanti, vlerësohen të gjitha së bashku për ndonjë zhvlerësim që mund t'i ketë ndodhur, duke grupuar së bashku aktivët financiarë huatë dhe paradhëniet të cilat paraqesin karakteristika të ngjashme të riskut.

Në lidhje me menaxhimin e provizioneve, Banka mund të vendosë për klasifikimin e ekspozimit në bazë të treguesve subjektivë, pavarësisht nga kriteret e përcaktuara më sipër, duke aplikuar kriteret e tjera të cilat zakonisht nuk janë plotësuar që mund të shfaqen në raste të veçanta. Prandaj, pagesat për huatë dhe paradhëniet të cilat nuk janë kryer për më shumë se 90 ditë dhe që tejkalojnë kriteret e materialitetit, janë subjekt i vlerësimit më vete. Zhvlerësimi matet si një diferencë midis vlerës së mbartur të huas dhe vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë që rezulton nga rikuperimi i kolateralit dhe/ose garancive që sigurojnë ekspozimin.

Të gjithë huatë për të cilat “nuk identifikohet asnjë fakt objektiv zhvlerësimi”, janë subjekt i vlerësimit kolektiv.

Këto hua ndahen në segmente duke krijuar grupe huaje me karakteristika të ngjashme. Banka ka llogaritur Normën Vjetore të Mospagesës (NVM) dhe Normën e Thjeshtuar të Humbjes nga Mospagesa (NHM) për segmentet/grupet me karakteristika të ngjashme duke marrë në konsideratë tregues si Segmentimi i Klientit, Ditët e Vonesës, Garancinë (mbulimi me kolateral) dhe ekspozimin/limitin e miratuar.

Normat e mospagesës janë përcaktuar në bazë të mesatares afat-gjate të kalimit të klientëve nga hua pa probleme në hua me probleme. Për çdo segment/grup huaje pa probleme, ecuria e debitorëve vlerësohet në momentin fillestar “t” dhe 12 muaj më pas “t + 12”. Vlerësimi realizohet duke marrë në konsideratë kundërpalët të cilët kalojnë nga kategoritë me risk të ulët në portofolin e huave me probleme të atij viti krahasuar me totalin e kundërpalëve ekzistues në fillim. Në periudhën që është subjekt vlerësimi, statusi i klientit konsiderohet me vonesë maksimale në lidhje me klasifikimin e huas. Për llogaritjen e NVM, Banka përdor mesataren e thjeshtë të normave vjetore të mospagesës të dy viteve të fundit. Sipas politikës së Bankës NVM rishikohet çdo vit.

NHM përcaktohen duke llogaritur reduktimin e ekspozimit të një klienti/transaksioni nga momenti i mospagesës (momenti kur klienti/transaksioni klasifikohet me rrezik të lartë) deri në fund të periudhës që është subjekt i vlerësimit (data e analizës). NHM përcaktohet për çdo pozicion që i përket kategorive të huave me probleme (të dyshimta, nën-standard, të ristrukturuara dhe me vonesë). Banka përdor metodën e Normës së Thjeshtuar të Humbjes nga Mospagesa duke marrë në konsideratë se për llogaritjen e “Metodës së Rikuperimit të Normës së Humbjes nga Mospagesa” nuk ka të dhëna historike. Norma e Thjeshtuar e Humbjes nga Mospagesa llogaritet për çdo kategori të përcaktuar më sipër duke përdorur provizionet e huave. Në përfundim llogaritet Humbja e Pritshme (HP) duke shumëzuar NVM, NH (Normën e Humbjes) dhe EP (Ekspozimin e Papaguar),- ekspozimet pa probleme në datën e llogaritjes. “Humbja e Përllogaritur” HP shndërrohet në humbje e realizuar (HR) duke e shumëzuar me PKH (“Periudhën e Konfirmimit të Humbjes”) faktori që përfaqëson periudhën midis ndodhjes së ngjarjes si rezultat i së cilës lind mospagesa dhe kohës së shfaqjes së sinjalit të mospagesës. Në datën e llogaritjes, për të gjithë klientët që kanë një ekspozim prej më shumë se 10% të Kapitalit Rregullator dhe vlerësohen “Ekspozime të Mëdha”, HR llogaritet duke shumëzuar ekspozimin aktual me normën e duhur minimale që sugjeron Banka.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të cilat janë matur me kosto të amortizuar llogariten në bazë të diferencës së shumës së mbartur të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të fluksit të përllogaritur të mjeteve monetare të skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen tek pasqyra e të ardhurave dhe paraqiten në llogarinë e fondit të huave dhe paradhënieve. Kur një ngjarje e mëvonshme influencon në zvogëlimin e shumës së humbjes nga zhvlerësimi i aktivitetit, humbja kthehet tek pasqyra e të ardhurave.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(h) Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve (vazhdim)

Fluksi i parashikuar i mjeteve monetare nga huatë dhe paradhëniet paraqiten me vlerën e skontuar të kolateralit. Kolaterali zbritet me norma dhe kohë rikuperimi të veçantë në varësi të llojit të kolateralit. Vlera e mbartur është shuma e principalit të duhur, principalit të papaguar, interesit të duhur, interesit të papaguar, penaltiteteve dhe tarifave gjyqësore pas zbritjes së rregullimit të paamortizuar.

Aty ku është e mundur Banka bën ristrukturimin/rinegociimin e huave sesa marrjen në zotërim të kolateralit. Kjo përfshin zgjatjen e afatit të pagesave për kthimin e huasë dhe marrëveshjen për kushte të reja kredie. Nëse kushtet dhe afatet e një aktivi financiar ri-negociohen ose modifikohen ose një aktiv financiar ekzistues zëvendësohet me një aktiv të ri për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë aktivi vlerësohet për zhvlerësim më vete.

Të gjithë klientët me një linjë të strukturuar kredie janë subjekt i testimi individual të zhvlerësimit dhe mbeten të tillë për një periudhë të paktën 2 vjeçare nga ristrukturimi, pavarësisht nga pagesat e kryera në bazë të kushteve të reja të përcaktuara për pagesat. Drejtimi në mënyrë të vazhdueshme rishikon kreditë e rinegociuara për të garantuar përmbushjen e të gjitha kriterëve dhe kryerjen e pagesave në të ardhmen.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari për fondin e huave dhe paradhëniet si dhe të investimeve në letra me vlerë të vendosjes, nëse ka. Nëse njohja e një ngjarje që ka ndodhur pas zhvlerësimit zvogëlon humbjen nga zhvlerësimi, zvogëlimi i humbjes nga zhvlerësimi rimerret përmes pasqyrës së të ardhurave.

Humbjet nga zhvlerësimi i investimeve në letra me vlerë të vendosjes njihen duke riklasifikuar humbjet në rezervën e të ardhurave të tjera përmbledhëse tek pasqyra e të ardhurave si rregullim në riklasifikim. Humbja kumulative e cila është riklasifikuar nga pasqyra e të ardhurave të tjera përmbledhëse tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve është diferenca midis kostos së blerjes, pa kthimin e principalit dhe amortizimit dhe vlerës së drejtë aktuale, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi që është njohur më parë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ndryshimet e provizioneve për zhvlerësim të cilat i atribuohen zbatimit të metodës së interesit efektiv pasqyrohen si një element përbërës i të ardhurave nga interesat.

Nëse, në një periudhë të mëvonshme, rritet vlera e drejtë e investimit në letra me vlerë të vendosjes të zhvlerësuar dhe rritja lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ka ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi, atëherë humbja nga zhvlerësimi kthehet dhe vlera e kthimit njihet në pasqyrën e të ardhurave. Megjithatë, çdo rikuperim i mëvonshëm i vlerës së drejtë të investimit në letra me vlerë të vendosjes të zhvlerësuar njihet gjithmonë në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse.

(i) Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë mjetet në arkë, llogaritë me bankat, gjendjet e pakufizuara me bankat qendrore dhe depozitat afatshkurtra shume likuide me maturitet më pak se 3 muaj, të cilat janë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjete monetare dhe të ngjashme mbahen në bilanc me koston e amortizuar.

(j) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim shitjen e tyre të menjëhershme ose në një kohë të afërt. Huatë dhe paradhëniet maten në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizimit plus kostot e tjera të transaksioneve direkte, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Pas matjes fillestare, ato maten me koston e amortizimit me normën efektive të interesit, duke zbritur vlerën e zhvlerësimit.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(j) Huatë dhe paradhëniet (vazhdim)

Amortizimi përfshihet në të ardhurat nga interesi në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet që rezultojnë nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave tek humbjet neto nga zhvlerësimi i mjeteve financiare.

(k) Investime në Letra me Vlerë

Investimet në letra me vlerë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e letrave me vlerë jo të tregtueshme, kostot e tjera të transaksioneve direkte, dhe më pas kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre si letra me vlerë të investimit, letra me vlerë të tregtueshme, ose letra me vlerë të vendosjes.

(i) Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimit janë aktive financiare jo derivative me të ardhura fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitete fikse që Banka ka qëllimin dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim dhe që nuk klasifikohen si të tregtueshme ose letra me vlerë të vendosjes.

Letrat me vlerë të investimit maten me koston e amortizuar nëpërmjet metodës së interesit efektiv duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi. Të gjitha shitjet dhe riklasifikimet e një shumë të konsiderueshme të letrave me vlerë të investimit që nuk janë afër maturimit riklasifikohen si investime në letra me vlerë të vendosjes dhe nuk e lejojnë Bankën t'i klasifikojë ato në investime në letra me vlerë të investimit për vitin ushtrimor aktual dhe dy vitet ushtrimore të ardhshëm.

(ii) Letra me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes janë instrumente jo derivative të cilat nuk përbëjnë një kategori tjetër të aktiveve financiare. Letrat me vlerë të vendosjes përfshijnë letrat me vlerë të borxhit. Letrat me vlerë të borxhit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbahen me kosto. Të gjitha letrat me vlerë të vendosjes mbarten me vlerën e drejtë. Të ardhurat nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave nëpërmjet metodës së interesit efektiv. Të ardhurat nga dividendët njihen në pasqyrën e të ardhurave kur Banka gëzon të drejtën mbi dividendin. Fitimet ose humbjet nga këmbimet valutore të investimeve në letra me vlerë të vendosjes njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi njihen tek pasqyra e të ardhurave. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen tek pasqyra e të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë të kapitalit. Nëse investimi shitet, gjendja në kapital, më parë e njohur në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse, riklasifikohet në pasqyrën e të ardhurave.

(l) Ndërtesat dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Ndërtesat dhe pajisjet paraqiten me koston e tyre neto pasi iu është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat mund t'i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes së mjetit. Nëse pjesë të një aktivi kanë jetëgjatësi përdorimi të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si elementë të veçanta (përbërësit kryesor) të ndërtesave dhe pajisjeve. Të gjitha fitimet ose humbjet nga shitja e një ndërtese dhe pajisje (të llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitje dhe vlera e mbartur e objektit) njihet me të ardhurat e tjera në pasqyrën e të ardhurave.

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(l) Ndërtesat dhe pajisjet (vazhdim)

(ii) Kosto të tjera rrjedhëse.

Kostot e zëvendësimit të një pjesë të një ndërtese ose pajisjeje njihen me vlerën e mbartur të aktivitet nëse është e mundur që të sigurohen përfitime të ardhshme ekonomike për Bankën dhe nëse kostot e tij mund të maten në mënyrë të besueshme.

(iii) Zhvlerësimi.

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së jetës së dobishme të çdo pjese të ndërtesës dhe pajisjes. Trualli dhe Veprat e Artit nuk zhvlerësohen. Jetëgjatësitë e parashikuara të përdorimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë të paraqitura si më poshtë:

• Ndërtesat	20 vjet
• Kompjuterët dhe pajisje të tjera kompjuterike	4-8 vjet
• Mobiliet, orenditë dhe pajisjet	3-10 vjet
• Aktive të tjera jo elektrike	5 vjet

(m) Aktive afat-gjata jomateriale

Programet kompjuterike, licencat dhe markat tregtare përbëjnë aktivet afatgjata jo-materiale dhe paraqiten me koston neto nga amortizimi i akumuluar. Shpenzimet e mëtejshme në aktivet afatgjata jo-materiale kapitalizohen vetëm nëse këto shpenzime rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik. Çdo lloj kostoje tjetër shpenzohet në periudhën në të cilën kryhet. Amortizimi pasqyrohet të pasqyra e të ardhurave duke përdorur metodën lineare të amortizimit për të gjithë jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata jo-materiale, duke filluar nga data e përdorimit të tyre. Jetëgjatësia e parashikuar për periudhën aktuale dhe krahasuese vijon si më poshtë:

• Programet kompjuterike	4 vjet
• Licencat dhe markat tregtare	10 vjet

(n) Inventari (Aktivet e marra në zotërim)

Aktivitet e marra në zotërim nëpërmjet ekzekutimit të garancisë që siguron huan me probleme dhe paradhëniet e klientit të cilat nuk janë shitur, nuk janë dhënë me qira, nuk janë në përdorim dhe janë planifikuar të shiten brenda një periudhe të shkurtër të arsyeshme, pa qenë objekt ristrukturimi të rëndësishëm, klasifikohen në kategorinë e inventarit. Aktivitet e marra në zotërim vlerësohen me vlerën më të ulët të koston dhe vlerën neto të realizueshme dhe të gjitha fshirjet e inventarit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave

(o) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo financiare të Bankës, të ndryshme nga të drejtat tatimore të shtyra, rishikohet çdo datë raportimi, për të përcaktuar nëse ka tregues të zhvlerësimit. Në rast se rezultojnë tregues të tillë, atëherë përlllogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivitet tejkalon shumën e rikuperimit. Vlera e rikuperueshme e një aktivitet është më e madhja prej vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot për t'u shitur. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, fluksi i të ardhurave të parashikuara skontohe në vlerë aktuale me normën e zbritjes para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut me vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të aktivitet. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi rimerren vetëm kur shumata e mbartur e aktivitet nuk e tejkalon shumën e mbartur që do të ishte përcaktuar, pa zhvlerësimin ose amortizimin, nëse nuk do të njëhej asnjë humbje nga zhvlerësimi.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(p) Depozitat dhe borxhet e varura

Depozitat dhe borxhet e varura përbëjnë burimet e financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për riblerjen e aktivit (ose të një aktivi të ngjashëm) me çmim fiks në një datë të ardhshme ("repo" ose "stock lending") marrëveshja kontabilizohet si depozite, dhe aktivi në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat dhe borxhet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe me pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, përveçse nëse Banka vendos të mbart detyrimet me vlerën e drejtë nëpërmjet njohjes në fitimit ose humbje.

(q) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshjet e anasjellta të riblerjeve) dhe letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për të riblere (marrëveshjet për riblerje), në përgjithësi trajtohen si transaksione financiare me kolateral në formën e parapagimeve ose arkëtimeve plus interesin e përllogaritur. Letrat me vlerë të marra mbi bazën e marrëveshjeve të riblerjes së anasjelltë dhe letrat me vlerë të dhëna sipas marrëveshjeve të riblerjes nuk njihen ose hiqen nga bilanci, derisa të hiqet dorë nga kontrolli i të drejtave kontraktuale të cilat përfshijnë këto letra me vlerë. Interesat e fituara nga marrëveshjet e riblerjeve të anasjellta dhe interesi i marrëveshjeve të riblerjeve njihen si të ardhura nga interesat ose shpenzime interesi për secilën marrëveshje, mbi kohëzgjatjen e çdo marrëveshje.

Kolaterale të mjete monetare për marrëveshjet e anasjellta të riblerjes/marrëveshjet e riblerjes
Transaksionet e huadhënies dhe huamarrjes së letrave me vlerë në përgjithësi janë të siguruara me letra me vlerë ose mjete monetare. Transferimi i letrave me vlerë kundrejt palëve pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse transferohen edhe risqet dhe shpërblimet e pronësisë. Paguesa ose arkëtimi paraprak si kolateral regjistrohet si aktiv ose pasiv. Informacion më i detajuar pasqyrohet në shënimet 10 dhe 15.

(r) Garancitë financiare

Garancitë financiare janë kontrata që kërkojnë që Banka të realizojë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që ka ndodhur si rezultat i mungesës së pagesës sipas termave kontraktuale për një instrument borxhi nga një debitor i caktuar. Detyrimet për garancitë financiare njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë, e cila amortizohet gjatë kohëzgjatjes së garancisë financiare.

Rrjedhimisht detyrimi i garancisë mbartet me vlerën me të lartë midis vlerës së amortizuar dhe vlerës aktuale të ndonjë pagese të pritshme (kur pagesa në lidhje me garancinë bëhet e mundshme). Garancitë financiare janë të përfshira tek detyrime të tjera.

(s) Provizionet

Një provizion mund të njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën, Banka disponon një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri dhe që gjithashtu është e mundur që të kërkojë dalje të përfitimeve ekonomike për të mbyllur detyrimin. Provizionet përcaktohen duke përdorur si normë skontimi për flukset e pritshme të parasë në të ardhmen, një norme para taksës e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe specifikat e riskut për detyrimin.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(t) Përfitimet e punonjësve (vazhdim)

(i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Banka operon vetëm me kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që sigurojnë përfitimet pensioni për personelin në momentin e daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjës për të siguruar minimumin e nivelit të pensionit sipas ligjit për pensionet në Shqipëri në bazë të një plani të përcaktuar kontributi për pensionin. Kontributet e Bankës ndaj përfitimeve të planit të pensionit pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(ii) Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtër të punonjësve llogariten mbi një bazë të paskontueshme dhe njihen si shpenzime kur shërbimi përkatës është siguruar. Një provizion njihet për vlerën e pritur për t'u paguar në bazë të një plani shpërblimi afat-shkurtër në mjete monetare ose plani për ndarjen e fitimit, nëse Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kryer në të kaluarën nga punonjësi dhe ky detyrim mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(u) Standardet e reja dhe interpretime ende të pa miratuara

Një numër standardesh të reja, ndryshime të standardeve dhe interpretimeve janë në fuqi për periudhat vjetore duke filluar pas datës 1 Janar 2014, megjithatë Banka nuk ka aplikuar standardet e reja ose të amenduara për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Standarde të reja ose të amenduara	Përmbledhje e kërkesave	Ndikimi i mundshëm në pasqyrat financiare
SNRF 9 <i>Instrumentet Financiare</i>	SNRF 9, publikuar në Korrik 2014, zëvendëson udhëzimin ekzistues të SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Vlerësimi. SNRF 9 përfshin udhëzimin e rishikuar për klasifikimin dhe vlerësimin e instrumenteve financiare, përfshirë një model të ri të humbjes së planifikuar të kredisë për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesat e reja të përgjithshme të kontabilitetit për fondin rezervë. Ky standard jep udhëzime të mëtejshme në lidhjen me njohjen dhe mos-njohjen e instrumenteve financiare nga SNK 39. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2018 dhe aplikimi i mëhershëm lejohet.	Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 9. Për shkak të natyrës së operacioneve të Bankës, ky standard pritet të ketë një ndikim të përgjithshëm në pasqyrat financiare të Bankës. Në veçanti, llogaritja e zhvlerësimit të instrumenteve financiare në bazë të humbjes së planifikuar nga kredia do të sjellë rritjen e nivelit të përgjithshëm të fondeve për zhvlerësimin.
SNRF 15 <i>Të ardhurat nga kontratat me klientët</i>	SNRF 15 përcakton një kuadër gjithëpërfshirës për përcaktimin e njohjes së vlerës dhe kohën e njohjes. Ky standard zëvendëson standardin ekzistues udhëzues për njohjen e të ardhurave, përfshirë SNK 18 Të ardhurat, SNK 11 Kontratat për Ndërtimin dhe IFRIC 13 Programet për Besnikërinë e Klientit. SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2017 dhe aplikimi i mëhershëm lejohet.	Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 15

Standardet e reja dhe të amendura që vijojnë më poshtë nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës.

- *Planet e Përcaktuara për Përfitimet: Kontributi i Punonjësit (Amendimet e SNK 19).*
- *Përmirësimet vjetore të SNRF gjatë ciklit 2010-2012.*
- *Përmirësimet vjetore të SNRF gjatë ciklit 2011-2013.*
- *SNRF 14 Llogaritë Rregullatore të Shtyra.*
- *Kontabilizimi i Interesave të Fituara nga Operacionet e Përbashkëta (Amendimet e SNK 16 dhe SNK 38). Bujqësia: Impiantet e zotëruesit (Amendimet e SNK 16 dhe SNK 41)*

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(u) Standardet e reja dhe interpretime ende të pa miratuara (vazhdim)

- *Metoda e Kapitalit në Pasqyra të Veçanta Financiare (Amendime të SNK 27).*
- *Shitja ose kontributi i aktiveve midis një Investitori dhe Shoqërisë ose Sipërmarrjes së Përbashkët (Amendime të SNRF 10 dhe SNK 28).*
- *Përmirësimet Vjetore të SNRF të periudhës 2012-2014 – standarde të ndryshme.*

4. Menaxhimi i Riskut Financiar

Si pasojë e përdorimit të instrumenteve financiare, Banka ekspozohet ndaj risqeve të mëposhtëm:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut
- risku operacional

Ky shënim jep informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej llojeve të risqeve të mësipërm, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut si dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Kuadri i Menaxhimit të Riskut

Këshilli Drejtues i Bankës ka përgjegjësinë kryesore për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të riskut të Bankës. Këshilli Drejtues ka krijuar Komitetet e Qeverisjes së Bankës (Komitetin Ekzekutiv, Komitetin e Drejtuesve Ekzekutiv, Komitetin e Riskut të Kredisë, Komitetin e Riskut Financiar, Komitetin e Riskut Operacional, Komitetin Lokal të Kredisë, Komitetin e Cilësisë së Aktiveve dhe Komitetet të tjera) të cilat kanë autoritetin për vendimmarrje sipas fushave të tyre të caktuara.

Divizioni i Administrimit të Riskut është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të riskut të Bankës në këto fusha. Të gjitha komitetet e Bankës kanë anëtarë ekzekutiv dhe jo ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Këshilli Drejtues për aktivitetet e tyre. Politikat e menaxhimit të riskut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar riskun me të cilin përballlet Banka, për të vendosur limitet dhe kontrollin e duhur si dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut si dhe produktet dhe shërbimet e ofruara.

(a) Risku i kredisë

Në aktivitetin normal të biznesit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë në huadhëniet dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, investimet në letra me vlerë dhe zërave të tjerë jashtë bilancit. Risku i kredisë është risku i një humbjeje financiare të Bankës nëse një klient ose palë e ngjashme që posedon një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktore që burojnë kryesisht nga huadhënia e Bankës ndaj klientëve, institucioneve financiare ose që burojnë nga zëra të tjerë jashtë bilancit. Për arsye raportimi të menaxhimit të riskut Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementet e ekspozimit të kredisë ndaj riskut (risku individual i mospërmbushjes së detyrimeve, risku i sektorëve të ekonomisë si dhe risku lokal). Banka e menaxhon ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë periodikisht duke monitoruar nga afër limitet e kredisë, portofolin e huave dhe përqendrimin e ekspozimit.

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Riskut të Kredisë (vazhdim)

Menaxhimi i Riskut të Kredisë

Këshilli Drejtues i Bankës i ka deleguar përgjegjësi për marrjen e vendimeve Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv (DPE), i cili i ka deleguar Komitetit Lokal të Kredisë kompetenca për vendimmarrje. Divizioni për Administrimin e Riskut, i cili raporton tek DPE, është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe administrimin e riskut të kredisë së Bankës, duke përfshirë detyrat e mëposhtme:

- *Formulimin e politikave të kredisë* duke u konsultuar me njësitë e biznesit, mbulimin e kërkesave për kolateral, vlerësimin e kredisë, përcaktimin e nivelit të riskut dhe raportimin e tij, procedurat e dokumentimit dhe ato ligjore, si dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullative dhe statutore.
- *Rishikimin dhe vlerësimin e riskut të kredisë.* Departamenti i Riskut të Kredisë të Bankës vlerëson të gjitha ekspozimet e kredisë përpara angazhimit me klientë nga Banka. Rinovimet dhe rishikimet e kushteve të kredive janë objekt i të njëjtit proces rishikimi.
- *Kufizimi i përqendrimit të ekspozimit* ndaj palëve, gjeografikisht dhe për nga industria, (për huadhënie dhe paradhënie) si dhe sipas lëshuesit, kategorisë së klasifikimit të kredisë, likuiditetit të tregut dhe vendit (për investimet në letrat me vlerë).
- *Zhvillimi dhe mirëmbajtja e klasifikimit të riskut të Bankës* në mënyrë që të kategorizojë ekspozimet sipas nivelit të riskut të humbjes financiare që përballet si dhe të fokusojë menaxhimin e risqeve të tjerë shoqërues. Klasifikimi i riskut përdoret për të përcaktuar nevojën e provigjionimit të nevojshëm të dëmeve ndaj ekspozimeve specifike të kredisë.

Në përputhje me metodologjinë e Bankës të gjitha ekspozimet janë të klasifikuara si ekspozime pa probleme dhe me probleme (duke përfshirë huatë e vonuara, të ristrukturuara, nën-standard dhe të dyshimta). Banka klasifikon portofolin e ekspozimeve me probleme duke analizuar ato në bazë të një grupi rregullash të harmonizuara me udhëzimet e Grupit. Këto rregulla përfshijnë faktet objektive si: shkelja e kontratës, moskryerja e pagesave të interesit dhe principalit; vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit; dhe informacione të tjera të rëndësishme financiare për klientin.

- *Rishikimi i përputhshmërisë* së njësive të biznesit me limitet e ekspozimit të miratuara duke përfshirë ato për industrinë e zgjedhura dhe llojet e produkteve. Komitetit të Cilësisë së Aktiveve i sigurohen raporte mujore të detajuara mbi cilësinë e kredive të portofoleve lokale ku gjithashtu paraqitet dhe tendenca e tyre dhe veprimet rregulluese të duhura që duhen ndërmarrë.
- *Ofrimi i konsultave, drejtimi dhe aftësi profesionale* ndaj njësive të biznesit për të promovuar në Bankë praktikën më të mirë të menaxhimit të riskut të kredisë.

Ekspozimi Maksimal ndaj Riskut të Kredisë pa marrë në konsideratë kolaterale apo ndonjë lehtësi tjetër kreditore (bruto nga ndonjë zhvlerësim)

Tabela e mëposhtme tregon ekspozimin aktual maksimal ndaj riskut të kredisë për komponentët e aplikueshëm të pasqyrës së pozicionit financiar:

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

Menaxhimi i Riskut të Kredisë (vazhdim)

	Ekspozimi Maksimal Bruto	
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Llogaritë me Bankën Qëndrore (duke përfshirë Arkën)	14,890,459	11,080,842
Hua dhe paradhënie bankave	25,343,535	21,027,977
Aktive financiare-letra me vlerë të vendosjes	3,969,543	2,363,630
Aktive financiare-letra me vlerë të investimit	57,309,439	56,162,536
Hua dhe paradhënie klientëve	47,188,237	50,912,099
Totali	148,701,213	141,547,081
Huadhënie të aprovuara por jo të disbursuara	7,425,526	3,974,300
Letër Kredi	829,112	126,603
Garanci të dhëna në favor të klientëve	5,346,600	4,766,894
Totali i angazhimeve në lidhje me kredisë	13,601,238	8,867,797
Totali i Ekspozimit ndaj Riskut të Kredisë	162,302,451	150,414,881

Ekspozimi maksimal i kredisë kundrejt një klienti apo grupi klientësh në 31 Dhjetor 2014 është 6,626,215 mijë Lek (2013: 6,287,714 mijë Lek) përpara marrjes në konsideratë të kolateraleve apo ndonjë lehtësie tjetër të kredisë.

Aty ku mjetet financiare regjistrohen me vlerën e drejtë, shumat e pasqyruara tregojnë ekspozimin aktual të riskut të kredisë, por jo ekspozimin maksimal të riskut i cili mund të rezultojë në të ardhmen si rezultat i ndryshimeve të vlerës. Banka i mundëson klientëve të saj garanci të cilat mund të kërkojnë që Banka të kryejë pagesa në përfitim të tyre dhe të ndërmarrë angazhime për të shtrirë më tej linjat e kredisë për të siguruar nevojat e tyre të likuiditetit.

Letër kreditë dhe garancitë e angazhojnë Bankën në kryerjen e pagesave në përfitim të klientëve në rast të një akti specifik, përgjithësisht i lidhur me importin dhe eksportin e mallrave. Të tilla angazhime e ekspozojnë Bankën në risqe kredie të ngjashme, të cilat zbuten nga të njëjtat procedura dhe politika kontrolli. Çdo muaj Banka vlerëson angazhimet e saj financiare për ndonjë zhvlerësim të mundshëm. Subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësime të mundshme të këtyre angazhimeve janë huatë e klientëve me probleme ose huatë e atyre klientëve që janë ristrukturuar.

Cilësia e Kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Tabela e mëposhtme tregon cilësinë e kredisë të aktiveve financiare të cilat janë të ekspozuara ndaj riskut të kredisë në bazë të klasifikimeve të brendshme të Bankës. Kategoria e mëposhtme e huave në ndjekje përfshin ekspozimet që kanë një vonesë prej më shumë se 90 ditë dhe janë zhvlerësuar në mënyrë kolektive (2013: 90 ditë). Zhvlerësimi kolektiv është shpërndarë sipas normës standarde të grupit me karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë ku bëjnë pjesë klientët.

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i Kredisë (vazhdim)

Cilësia e Kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Aktivët financiarë në tabelën e mëposhtme paraqiten bruto pa zbritjet për zhvlerësimet për të dy vitet financiare më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013:

31 Dhjetor 2014	As me vonesë as të zhvlerësuara individualisht	Me vonesë por jo të zhvlerësuara individualisht	Individualisht të zhvlerësuara	Totali
Llogari me Bankën Qendrore (duke përjashtuar Arkën)	14,890,459	-	-	14,890,459
Hua dhe paradhënie bankave	25,343,535	-	-	25,343,535
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	27,749,739	1,169,413	9,600,674	38,519,825
Hua hipotekore	4,835,224	833,697	1,117,527	6,786,448
Hua konsumatore	1,715,477	21,686	144,801	1,881,964
Aktive financiare-letra me vlerë të vendosjes				
Kompani të Listuara	2,106,528	-	-	2,106,528
Kompani jo të Listuara	1,863,015	-	-	1,863,015
Aktive financiare-letra me vlerë të investimit				
Kompani të Listuara	5,114,010	-	-	5,114,010
Kompani jo të Listuara	52,195,429	-	-	52,195,429
Totali	135,813,415	2,024,796	10,863,001	148,701,213

31 Dhjetor 2013	As me vonesë as të zhvlerësuara individualisht	Me vonesë por jo të zhvlerësuara individualisht	Individualisht të zhvlerësuara	Totali
Llogari me Bankën Qendrore (duke përjashtuar Arkën)	11,080,842	-	-	11,080,842
Hua dhe paradhënie bankave	21,027,977	-	-	21,027,977
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	26,634,673	2,237,831	12,633,420	41,505,924
Hua hipotekore	4,609,991	989,781	696,239	6,296,011
Hua konsumatore	1,271,834	297,481	1,540,851	3,110,166
Aktive financiare-letra me vlerë të vendosjes				
Kompani të Listuara	726,459	-	-	726,459
Kompani jo të Listuara	1,637,170	-	-	1,637,170
Aktive financiare-letra me vlerë të investimit				
Kompani të Listuara	6,518,909	-	-	6,518,909
Kompani jo të Listuara	49,643,627	-	-	49,643,627
Totali	123,151,480	3,525,093	14,870,510	141,547,083

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i Kredisë (vazhdim)

Cilësia e Kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Huatë dhe paradhëniet klientëve janë e vetmja kategori e aktiveve financiare që kanë grupin e huave në ndjekje por jo të zhvlerësuar individualisht. Pjesa tjetër e aktiveve financiare nuk kanë një kategori të ekspozimeve në ndjekje. Analiza e ekspozimeve në ndjekje për periudhën 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

31 Dhjetor 2014	91 në 180 ditë	më shumë se 180 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:			
Hua tregtare	681,261	488,152	1,169,413
Hua hipotekore	217,836	615,861	833,697
Hua konsumatorë	10,771	10,915	21,686
Totali	909,868	1,114,928	2,024,796

31 Dhjetor 2013	91 ne 180 ditë	me shumë se 180 dite	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:			
Hua tregtare	730,956	1,506,875	2,237,831
Hua hipotekore	350,525	639,256	989,781
Hua konsumatore	8,376	289,105	297,481
Totali	1,089,857	2,435,236	3,525,093

Vlera e mbartur sipas kategorive të aktiveve financiare për të cilat kushtet janë rinegociuar.

Tabela më poshtë tregon vlerën e mbartur të huave dhe paradhënieve për klientët, të cilat janë ristrukturuar sipas produkteve:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Hua tregtare	96,091	54,785
Hua hipotekore	43,291	2,075
Hua konsumatorë	1,858	1,347
Totali	141,240	58,207

Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuar

Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuar janë ato për të cilat Banka vlerëson se mund të mos jetë në gjendje të mbledhë principalin dhe interesin e arkëtueshëm sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes(ve) së huas. Banka i klasifikon huadhëniet dhe parapagimet ndaj klientëve në kategori pa probleme dhe me probleme në përputhje me metodologjinë e Bankës sipas SNRF; ndërkohë që kryen teste të zhvlerësimit për të gjitha huadhëniet që shfaqin prova objektive për zhvlerësim, duke vlerësuar të skontuar fluksin e ardhshëm të parasë dhe duke e krahasuar me shumën e mbetur për huatë respektive.

Huatë, provat objektive të të cilave nuk përmbushin kushtet për t'u testuar individualisht si të zhvlerësuar, testohen së bashku duke përdorur normat historike standarde të Bankës, normat e humbjes, periudhën e konfirmimit të humbjes për grupe kredish me karakteristika të ngjashme të riskut. Zhvlerësimi kolektiv shpërndahet për klientë të testuar individualisht por që kane rezultuar të mos kenë nevojë për zhvlerësim individual.

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i Kredisë (vazhdim)

Zbritjet për zhvlerësim

Banka përcakton një fond për humbjet nga zhvlerësimi i kredive që përfaqëson një përlogaritje për humbjet në portofolin e kredive. Komponentët kryesorë të kësaj zbritjeje përfshijnë një komponent të humbjes specifike që lidhet me ekspozimet e rëndësishme individuale, dhe një zbritje për humbjet në huatë e vlerësuara kolektivisht, të vendosura për grupe aktivesh homogjene në lidhje me humbjet që kane ndodhur por që nuk janë identifikuar në huatë si objekt i vlerësimit individual për zhvlerësim.

Tabela më poshtë tregon ekspozimin neto të huave dhe paradhënies për klientët e klasifikuar në dy grupe kryesore: individualisht ose kolektivisht të zhvlerësuara.

	Ekspozimi Neto i huave dhe paradhënies klientëve	
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Individualisht të zhvlerësuara		
Shuma bruto	10,863,001	14,870,510
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(6,313,594)	(6,927,895)
Vlera kontabël	4,549,407	7,942,615
Kolektivisht të zhvlerësuara		
Shuma bruto	36,325,236	36,041,590
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(533,249)	(552,793)
Vlera kontabël	35,791,987	35,488,797
Total i vlerës kontabël të Huave dhe paradhënies për klientët	40,341,394	43,431,412

Lëvizjet e veçanta të zbritjeve për zhvlerësime individuale e kolektive paraqiten në shënimin 11.

Më poshtë paraqitet një analizë e shumave bruto dhe neto (e zbritjeve për zhvlerësime) për huatë e zhvlerësuara individualisht sipas klasifikimit të riskut:

	Hua dhe paradhënie klientëve individualisht të zhvlerësuara	
	Bruto	Neto
31 Dhjetor 2014		
Hua pa probleme	38,905	37,913
Hua në ndjekje	190,857	131,923
Hua nën-standarde	1,757,718	1,313,380
Hua të dyshimta	23,609	15,664
Hua të ristrukturuara	8,851,912	3,050,527
Totali	10,863,001	4,549,407
31 Dhjetor 2013		
Hua pa probleme	1,227,273	1,194,994
Hua në ndjekje	714,074	506,026
Hua nën-standarde	2,132,480	1,393,557
Hua të dyshimta	11,792	-
Hua të ristrukturuara	10,784,891	4,848,038
Totali	14,870,510	7,942,615

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i Kredisë (vazhdim)

Politikat e fshirjes nga librat kontabël

Banka fshin nga librat një huadhënie (dhe zbritjet për zhvlerësime nga humbje të lidhura me të) kur Këshilli Drejtues i Bankës përcakton se kredia është e paarkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacionit për ndodhjen e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit, në mënyrë të tillë që huamarrësi nuk paguan dot më detyrimet ose të ardhurat dhe përfitimet nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të shlyer të gjithë ekspozimin.

Fluksi i parashikuar i të ardhurave nga kolaterale dhe/ose garancitë që mbulojnë ekspozimet konsiderohet si fluks parash në të ardhmen për linjat e kredisë. Disa nga parametrat e vlerësimit të përdorura për llogaritje janë:

- *Vlera e realizueshme e kolateraleve*, e cila përllogaritet duke ulur vlerën e kolateraleve të vlerësuara me një 'faktor skontimi'. Kjo e fundit merr në konsideratë karakteristikat e grupeve të ngjashme të kolateraleve. Kjo nënkupton vlerën mesatare të rikuperueshme të një kolaterali të caktuar, i bazuar në eksperiencën tonë të procesit të rikuperimit të kolateraleve.
- *Koha e flukseve të parashikuara të parasë*, e cila i referohet kohës së pritshme të rikuperimit (në vite) të një lloji të caktuar kolaterali.

Kostot e rikuperimit zbriten nga fluksi i ardhshëm i parashikuar i parasë. Kolaterali përgjithësisht nuk mbahet për huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare, përveç kur instrumentet financiare mbahen si pjesë e marrëveshjeve të ndërsjellta dhe aktivitetit të huamarrjes nëpërmjet instrumenteve financiare. Zakonisht, pengu nuk mbahet kundrejt instrumenteve të investimit, dhe asnjë peng i tillë nuk është mbajtur në 31 Dhjetor 2014 ose 2013. Parashikimet për vlerën e drejtë janë të bazuara në vlerën e kolateraleve të vlerësuara në momentin e marrjes së borxhit, dhe janë gjithashtu të rishikueshme çdo tre vjet. Një përllogaritje e vlerës së drejtë të paskontuar dhe të skontuar të kolateraleve dhe instrumenteve të tjerë garantues, të mbajtur kundrejt aktiveve financiare tregohet më poshtë:

Ndaj të zhvlerësuarave Individualisht	Kolaterale për Huatë dhe paradhëniet klientëve 31 Dhjetor 2014		Kolaterale për Huatë dhe paradhëniet klientëve 31 Dhjetor 2013	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto
Ndërtesa	20,882,198	9,328,777	14,471,874	5,687,758
Letra me vlere te borxhit	1,067,334	351,071	893,750	272,652
Pengje & Garanci	8,284,333	130,040	5,715,025	218,555
Të tjera	56,056	-	56,080	-
Totali	30,289,921	9,809,888	21,136,729	6,178,965

Shuma bruto e kolateralit përfshin vlerën e kolateralit përpara testimit të huave individualisht të zhvlerësuara. Shuma neto tregon vlerën e aktualizuar të njëjtë kolateral pas këtij testi. Tabela më poshtë tregon totalin e kolateraleve për huadhëniet e vlerësuara në kategorinë e zhvlerësimit kolektiv. Këto kolaterale nuk kalojnë në të njëjtën procedurë testimi si grupi më sipër, kështu që vetëm vlera bruto është paraqitur. Informacioni në tabelën e mëposhtme tregon se sa janë të siguruara huatë dhe paradhëniet e klientëve të zhvlerësuara kolektivisht ndaj kolateralit përkatës të tyre.

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i Kredisë (vazhdim)

	Kolaterale për Huat dhe paradhëniet klientëve	
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Ndaj të zhvlerësuarave Kolektivisht		
Ndërtesa	69,706,670	81,544,351
Pengje & Garanci	22,059,328	17,119,023
Mjete monetare	3,642,598	2,759,553
Letra me vlerë të borxhit	1,392,875	1,319,699
Të tjera	2,524,448	1,549,309
Totali	99,325,919	104,291,935

Banka ka si politikë që të shesë (të mos mbajë) aktivet që mban nëpërmjet procesit të rikuperimit. Vlerat që mbliidhen nga të ardhurat e shitjes së aktivitet përdoren për të zvogëluar ose shlyer vlerën e mbartur të huave me probleme.

Në rastin e kolateraleve në pronësi të Bankës, konvertimi i tyre në para është qëllimi kryesor i Bankës, e cila ndërmer një marketing të mirëfilltë për shitjen e pronave. Nëse nuk ka asnjë ofertë të mirë të mbledhur deri në një moment të caktuar, Banka ka si procedurë të mbajë aktivin në inventarët e saj për shitje deri sa të marrë ofertën më të mirë. Në varësi të veprimtarisë së Bankës dhe nevojave të saj dhe përshtatshmërisë së aktivitet për t'i plotësuar ato nevoja, menaxhimi vendos ta vere në përdorim atë, rrjedhimisht bëhet një riklasifikim në aktivet operacionale të Bankës. Natyra dhe vlerat përkatëse të inventarit të kolateraleve paraqiten në shënimin 14.

Banka monitoron përqendrimet e riskut të kredisë sipas sektorëve dhe vendit. Analiza e riskut të kredisë në datën e raportimit paraqitet si më poshtë:

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(a) Risku i Kredisë (vazhdim)

	Letra me vlerë	
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Qeveri Qendrore		
Klasifikimi Aaa	419,472	419,570
Klasifikimi Baa2	3,671,550	3,446,518
Klasifikimi B1	52,239,960	49,687,623
Klasifikimi i pa disponueshem	1,382,974	1,242,780
	57,713,956	54,796,491
Banka		
Klasifikimi Aaa	1,131,368	563,392
Klasifikimi Baa1	786,914	1,723,558
Klasifikimi Baa2	1,220,355	1,062,156
Klasifikimi Baa3	247,168	219,159
Klasifikimi Ba3	-	161,410
Klasifikimi Ba1	179,221	-
	3,565,026	3,729,675
Totali Vlerës kontabël	61,278,982	58,526,166

Risku i shlyerjes

Aktivitetet e Bankës mund të krijojnë risk në kohën e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimit. Risku i shlyerjes është risku i humbjes për shkak të dështimit të një kompanie për të shlyer detyrimet për dhënien e parasë në dorë, letrave me vlerë ose aktiveve të tjera sipas marrëveshjes kontraktuale. Risku i shlyerjes me institucione financiare dhe partnere qeveritar përfshihet brenda një sistemi kufizimesh për të gjitha transaksionet me këta partnere dhe është objekt i monitorimit të përditshëm.

Limitet e ekspozimit me palët e treta të vendosura nga Shoqëria Mëmë me institucionet financiare nuk janë respektuar në muajin shtator 2014 me Bankën Societe Generale për shkak të luhatjes së kursit të këmbimit. Ndërkohë limiti i ekspozimit me palët e treta, i vendosur nga Banka e Shqipërisë kundrejt Grupit ISP në masën prej 20% të kapitalit rregullator, është thyer në 31 Dhjetor 2014, për shkak të zvogëlimit të kapitalit rregullator, që vjen si pasojë e kapitalizimit të aktiveve jomateriale.

(b) Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e një institucioni për të plotësuar detyrimet që ka për pagesa për shkak të paaftësisë për të likuiduar aktive ose për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (risku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit të aktiveve financiare që shoqërohen me ndryshime të rëndësishme negative të çmimeve, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

Menaxhimi i riskut të likuiditetit

Metoda e Bankës për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë sa më shumë të jetë e mundur, që do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj kur duhet, në kushtet si normale dhe jonormale, pa pësuar humbje të papranueshme ose që rrezikojnë dëmtimin e reputacionit të Bankës. Banka përcakton udhëzimet për menaxhimin e riskut të likuiditetit dhe një plan emergjence të cilat janë objekt i rishikimit nga strukturat e Grupit, dhe aprovimi nga Komiteti i Riskut Financiar të ISBA dhe Këshilli Drejtues. Divizioni i Financës dhe Tregut të Kapitalit është përgjegjës për menaxhimin e likuiditetit dhe Divizioni i Administrimit të Riskut është përgjegjës për monitorimin e treguesve dhe verifikimin e zbatimit të limiteve.

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(b) Risku i Likuiditetit (vazhdim)

Banka ka përditësuar rregulloren e saj për Administrimin e Riskut të Likuiditetit për të qenë në përputhje të plotë me udhëzimin e ri të Grupit ISP për Riskun e Likuiditetit, lëshuar në Janar 2014 dhe miratuar nga Këshilli Drejtues në Shtator 2014. Banka monitoron likuiditetin në përputhje me këtë rregullore që të menaxhojë detyrimet e saj kur duhen realizuar si dhe që të aktivizojë procedura emergjence në rast përshkallëzimi. Një raport i balancuar duhet të ruhet midis burimeve hyrëse dhe fluksit në dalje, si në planin afatshkurtër dhe në atë afatmesëm. Objektivi është organizuar sipas përdorimit të metrikave specifike që vijojnë më poshtë “Raporti afatshkurtër i mbulimit të likuiditetit deri në 1 muaj” dhe “Raporti i financimit të qëndrueshëm neto”:

- **Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (RML):** ka si qëllim që Banka të ruaj një nivel të përshtatshëm të aktiveve likuide me cilësi të lartë (ALCL) për të përmbushur nevojat e saj afat-shkurtër për likuiditet sipas skenarit të provës së rezistencës së likuiditetit ($RML \geq 80\%$);
- **Raporti i Financimit të Qëndrueshëm Neto (RFQN):** ka si qëllim të garantojë një pozicion të përshtatshëm likuiditeti për një periudhë kohore afat-mesme/afatgjate. Ai përcakton shumën minimale të pranueshme të financimit për një periudhë një vjeçare në lidhje me nevojat që lindin nga karakteristikat e likuiditetit dhe maturimit të mbetur të ekspozimeve të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit ($RFQN > 90\%$).

Mbajtja e rezervave të aktiveve likuide (e njohur si “Zbutës i Likuiditetit”) është një nga mjetet kryesore për zbutjen e riskut të likuiditetit. Për identifikimin dhe matjen e këtij risku, afatmesëm dhe afatgjatë, klasifikimi i aktiveve shumë likuide merr një rëndësi domethënëse.

Në vijim, Banka përgatit rregullisht skenarë likuiditeti sipas udhëzimeve të Grupit, të tilla si situata specifike krize financiare në treg.

Një llogaritje e ngjashme por jo e njëjtë përdoret për të vlerësuar përputhshmërinë e Bankës me limitet e likuiditetit të vendosur nga Banka e Shqipërisë, e cila në të gjitha monedhat duhet të jetë mbi 20% dhe mbi 15% veçmas për monedhën vendase dhe monedhat e huaja. Rregullorja e Bankës së Shqipërisë parashikon që Banka ti mbajë 10% të depozitave të saj me afat maturimi jo më pak se 2 vjet si një rezervë e detyrueshme me Bankën Qendrore.

Raportet afatshkurtra të likuiditetit të bankës monitorohen në mënyrë periodike nga Grupi në lidhje me limitet e brendshme dhe udhëzimet e Grupit dhe të Bankës Qendrore.

Raportet afatshkurtra të likuiditetit të bankës kanë qenë brenda limiteve gjatë gjithë vitit 2014. Në vijim, raportet e strukturës së likuiditetit të Bankës llogariten nga Grupi në përputhje me metodologjinë dhe rregulloret e Bankës së Italisë dhe kanë rezultuar përsëri brenda limiteve të kërkuara.

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(b) Risku i Likuiditetit (vazhdim)

Tabela më poshtë tregon situatën e likuiditetit të Bankës siç monitorohet aktualisht nga menaxhimi i Bankës, në bazë të rregullores së brendshme lokale dhe Udhëzimeve të Grupit për likuiditetin më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013. Ajo merr në konsideratë flukset e parasë të pa skontuara hyrëse/dalëse të Bankës për të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare në dhe jashtë bilancit, sipas skenarit kryesor të Bankës e cila përfshin maturitetin kontraktual dhe nuk reflekton supozimet për historikun e mbajtjes ose likuidimet përpara afatit. Ajo reflekton supozimet e një skenari si: rezerva e likuiditetit – rezervat e linjës së parë, të dytë dhe të tretë (shih më poshtë klasifikimin e letrave me vlerë të vendosjes dhe të letrave me vlerë të investimit), koeficientet e sjelljes që aplikohen për llogaritë rrjedhëse dhe paradhëniet bankare ofruar klientëve dhe përqindjet e zbritura nga kategoritë e zërave jashtë bilancit si linjat e kredive dhe garancitë.

	deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vjet	> 5 vjet	Totali
31 Dhjetor 2014						
Aktivet (Fluksi i mjeteve monetare hyrëse)	69,413,547	10,685,874	17,908,314	38,827,757	11,353,156	148,188,648
Arka neto	999,313	-	-	-	-	999,313
Kërkesat minimale për rezervën	208,984	-	-	11,086,393	-	11,295,377
Paradhënie bankave	8,913,033	-	-	-	-	8,913,033
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së parë	560,849	-	-	-	-	560,849
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së dytë	49,077,073	-	-	-	-	49,077,073
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së tretë	1,235,689	4,979,919	4,140,285	7,550,718	843,866	18,750,477
Hua Bankave	5,968,183	3,696,655	7,811,639	2,856,634	-	20,333,111
Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)	2,450,423	2,009,300	5,956,390	17,334,012	10,509,290	38,259,415
31 Dhjetor 2014						
Detyrime (Fluksi i mjeteve monetare dalëse)	(18,751,363)	(14,506,632)	(43,963,666)	(18,979,670)	(31,858,892)	(128,060,223)
Depozita nga bankat dhe klientët - llogari rrjedhëse	(4,492,938)	(1,930,842)	(3,861,684)	(7,723,368)	(31,858,892)	(49,867,724)
Llogari rrjedhëse me bankat	(102,745)	-	-	-	-	(102,745)
Llogari rrjedhëse me klientët	(4,390,193)	(1,930,842)	(3,861,684)	(7,723,368)	(31,858,892)	(49,764,979)
Depozita nga bankat, nga të cilat:	(4,512,558)	(1,047,758)	-	-	-	(5,560,316)
“Cash” për repo dhe për letrat me vlerë të dhëna borxh	(708,500)	(1,047,758)	-	-	-	(1,756,258)
Depozita nga klientët - Depozita me afat	(9,745,867)	(11,528,032)	(40,101,982)	(9,728,951)	-	(72,632,183)
Total GAP zëra jashtë bilancit	50,662,184	(3,820,758)	(26,055,352)	19,848,087	(20,505,736)	20,128,452
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Dalëse)	(813,524)	-	-	-	-	(813,524)
Total GAP zëra jashtë bilancit	(813,524)	-	-	-	-	(813,524)
Total GAP 31 Dhjetor 2014	49,848,660	(3,820,758)	(26,055,352)	19,848,087	(20,505,736)	19,314,901
GAP i akumuluar 31 Dhjetor 2014	49,848,660	46,027,902	19,972,550	39,820,637	19,314,901	

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(b) Risku i Likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2013	deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vjet	> 5 vjet	Totali
Aktivët (Fluksi i mjeteve monetare hyrëse)	35,478,141	8,202,982	15,171,054	54,639,953	14,173,612	127,665,742
Arka neto						
Kërkesat minimale për rezervën						
Paradhënie bankave	3,415,493	-	-	-	-	3,415,493
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së parë	570,072	-	-	-	-	570,072
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së dytë	20,329,162	-	-	-	-	20,329,162
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së tretë	1,041,666	5,206,145	4,322,129	33,169,492	3,153,700	46,893,132
Hua Bankave	7,684,081	1,025,416	5,065,440	4,657,961	-	18,432,898
Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)	2,437,667	1,971,421	5,783,485	16,812,500	11,019,912	38,024,985
31 Dhjetor 2013	deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vjet	> 5 vjet	Totali
Detyrime (Fluksi i mjeteve monetare dalëse)	(19,741,209)	(14,775,880)	(49,975,554)	(10,325,185)	(24,351,119)	(119,168,947)
Depozita nga bankat dhe klientët - llogari rrjedhëse	(5,650,139)	(1,475,825)	(2,951,651)	(5,903,302)	(24,351,119)	(40,332,036)
Llogari rrjedhëse me bankat	(1,443,586)	-	-	-	-	(1,443,586)
Llogari rrjedhëse me klientët	(4,206,553)	(1,475,825)	(2,951,651)	(5,903,302)	(24,351,119)	(38,888,450)
Depozita nga bankat, nga të cilat:	(3,815,942)	-	-	-	-	(3,815,942)
“Cash” për repo dhe për letrat me vlerë të dhëna borxh	(1,814,893)	-	-	-	-	(1,814,893)
Depozita nga klientët - Depozita me afat	(10,275,128)	(13,300,055)	(47,023,903)	(4,421,883)	-	(75,020,969)
Total GAP zëra jashtë bilancit	15,736,932	(6,572,898)	(34,804,500)	44,314,768	(10,177,507)	8,496,795
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Dalëse)	(454,033)	-	-	-	-	(454,033)
Total GAP zëra jashtë bilancit	(454,033)	-	-	-	-	(454,033)
Total GAP 31 Dhjetor 2013	15,282,899	(6,572,898)	(34,804,500)	44,314,768	(10,177,507)	8,042,762
GAP i akumuluar 31 Dhjetor 2013	15,282,899	8,710,001	(26,094,499)	18,220,269	8,042,762	

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(b) Risku i Likuiditetit (vazhdim)

Informacioni i siguruar lidhet me fluksin e parasë që vjen nga detyrimet financiare, kështu që ndryshon konsiderueshëm nga prezantimi në bilanc. Analiza nuk përfshin detyrimet jo-financiare, dhe kapitalin dhe përfshin flukset e parasë me interes kontraktual.

Tabela më poshtë tregon detyrimet e kushtëzuara dhe angazhimet financiare të Bankës:

31 Dhjetor 2014	1 Muaj	1-3 Muaj	3-12 Muaj	1-5 Vjet	>5 Vjet	Totali
Angazhime	7,425,526	-	-	-	-	7,425,526
Garanci	6,175,712	-	-	-	-	6,175,712
31 Dhjetor 2013						
Angazhime	4,212,662	-	-	-	-	4,212,662
Garanci	4,893,497	-	-	-	-	4,893,497

Banka pret që vetëm një pjesë e vogël e angazhimeve të kërkohe brenda një muaji dhe garancitë të mbyllen sipas afatit të maturimit. Referojuni dhe shënimit 30 Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara.

Rakordimi ndërmjet tabelës së maturitetit të angazhimeve dhe detyrimeve të kushtëzuara dhe shënimit 30. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara vijojnë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Angazhime	7,425,526	4,212,662
Hua të aprovuara jo të disbursuara	7,425,526	4,212,662
Garanci	6,175,712	4,893,497
Letër Kredi	829,112	126,603
Garanci në favor të klientëve	5,346,600	4,766,894

(c) Risku i Tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, si norma e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, spread-et e kredisë (jo të lidhura me ndryshime të gjendjes së debitorit/kreditorit) do të ndikojnë fitimet e Bankës ose vlerën e mbajtjes së instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke maksimizuar kthimin mbi riskun.

Menaxhimi i Risqeve të Tregut

Me aplikimin e SNRF si kuadër kontabël, Banka bëri një ndarje të portofolit të letrave me vlerë në përputhje me SNK 39 në letra me vlerë të tregtueshme, letra me vlerë të investimit ose të vendosjes.

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(c) Risku i Tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit

'Risku i kursit të këmbimit' përkufizohet si mundësia që luhatjet e kurseve të këmbimit të prodhojnë ndryshime të rëndësishme, si pozitive dhe negative në bilancin e Bankës. Burimet më të rëndësishme të riskut të normës së këmbimit konsistojnë në:

- Huadhëniet dhe depozitat në monedhë të huaj të korporatave dhe individëve;
- Investime në letrat me vlerë në monedhë të huaj;
- Tregtimi i kartëmonedhave të huaja;
- Arkëtimi ose pagesa e interesit, komisioneve, kostove administrative, etj. në monedha të huaja.

Ekspozimi i Bankës ndaj riskut të kursit të këmbimit monitorohet çdo ditë nga Departamenti i Riskut të Tregut dhe Operacional që siguron përputhshmëri me limitet e brendshme dhe rregullative. Rregulloret e brendshme caktojnë kufizime për çdo pozicion të hapur valutor, për pozicione të hapura globale, për humbje maksimale dhe Vlerën me Risk ("VaR"). Analiza e detajuar në bazë të të dhënave historike një vjeçare u realizua për të konfirmuar/përcaktuar kufizimet e mësipërme. Kufizimet rregullative të sistemit bankar i referohen një limiti maksimal prej 20 % të një pozicioni të hapur për çdo valutë dhe 30% për pozicionin e përgjithshëm valutor.

Metodologjitë e vlerësimit për llogaritjen e Vlerës me Risk (VaR-it) të përfshira në procedurat e brendshme janë të bazuara në teknikën e stimulimit të ponderimit historik. Peshat që janë përdorur në model janë përcaktuar duke aplikuar një funksion zbritës me një faktor skontues të koeficienteve të sjelljes prej 0.992 dhe periudha kohore përfshin 250 ditë në përputhje me Udhëzimet e Grupit. VaR-i i vlerësuar në një nivel besimi prej 99% dhe periudhë mbajtjeje 1 ditore, ishte Lek 0.6 milion më 31 Dhjetor 2014, me një mesatare përgjatë vitit prej Lek 0.5 milion (2013: Lek 1.2 milion dhe mesatarisht Lek 0.5 milion).

Efektiviteti i llogaritjeve të VaR-it është monitoruar çdo ditë nëpërmjet testeve, krahasimit të vlerësimeve të vlerës me risk me humbjet e përealizuara. Vlerësimi parashikon se Vlëra me Risk përcakton në mënyrë precize vlerën e fitimit ose humbjes së përealizuar ditore. Niveli i vlerës me risk rezultoi brenda limiteve të vendosura për vitin 2014 dhe 2013 dhe 'limiti ndal humbjes' rezultoi brenda limitit gjatë vitit 2014 dhe 2013.

Banka ka ruajtur limitet gjatë vitit 2014 edhe në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë.

Aktivët financiarë në monedha të huaja janë të paraqitura në çdo shënim respektiv të pasqyrave financiare.

.

4. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i Tregut (vazhdim)

Aktive	LEK	USD	EUR	Te tjera	Totali
Mjete monetare e të ngjashme	644,486	4,626,236	10,197,018	422,736	15,890,476
Hua dhe paradhënie bankave	4,714,663	3,500,191	16,948,063	180,618	25,343,535
Letra me vlerë të vendosjes	39,445	2,823,151	738,940	368,007	3,969,543
Letra me vlerë të investimeve	49,733,088	2,774,416	4,444,608	357,327	57,309,439
Hua dhe paradhënie klientëve	14,314,834	2,121,819	23,904,656	85	40,341,394
Ndërtesa dhe pajisje	1,398,437	-	-	-	1,398,437
Aktive afatgjata jo-materiale	554,635	-	-	-	554,635
Të drejta tatimore të shtyra	76,962	-	-	-	76,962
Të drejta tatimore afatshkurtra	507,139	-	-	-	507,139
Mjete të tjera	434,998	10,858	2,194,470	2,198	2,642,524
Aktive gjithsej (1)	72,418,687	15,856,671	58,427,755	1,330,971	148,034,084
Detyrime					
Detyrime ndaj bankave	5,586,440	1,858	74,829	12	5,663,139
Detyrime ndaj klientëve	49,847,106	15,089,168	55,031,875	1,311,526	121,279,675
Borxhi i varur	-	-	-	-	-
Provizione	249,594	3,499	178,738	142	431,973
Detyrime të tjera	850,474	24,099	200,162	663	1,075,398
Detyrimet tatimore afatshkurtra	300,272	-	-	-	300,272
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-	-	-	-
Kapitali aksionar, neto	19,184,058	95,798	(2,481)	6,252	19,283,627
Detyrime gjithsej (2)	76,017,944	15,214,422	55,483,123	1,318,595	148,034,084
Pozicioni valutor neto më 31 Dhjetor 2014 (1)-(2)	(3,599,257)	642,249	2,944,632	12,376	-
Aktive jashtë bilancit	8,613,617	9,267,566	113,015,476	-	130,896,659
Detyrime jashtë bilancit	8,613,617	9,267,566	113,015,476	-	130,896,659
Pozicioni valutor neto jashtë bilancit më 31 Dhjetor 2014	82,885	53,249	(135,981)	14,026	14,179
Totali i pozicionit valutor 31 Dhjetor 2014	(3,516,372)	695,498	2,808,651	26,402	14,179
Aktive më 31 Dhjetor 2012	65,995,499	17,167,493	54,843,712	1,231,083	139,237,787
Detyrime më 31 Dhjetor 2013	69,503,177	16,746,682	51,763,417	1,224,511	139,237,787
Pozicioni valutor neto jashtë bilancit më 31 Dhjetor 2013	82,885	53,249	(135,981)	14,026	14,179
Totali i pozicionit valutor 31 Dhjetor 2013	(3,424,793)	474,060	2,944,314	20,598	14,179

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(c) Risku i Tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj riskut te normës se interesit

Risku kryesor i normës se interesit ndaj të cilit janë të ekspozuar portofolet e Bankës është risku i humbjes nga luhatjet e flukseve të ardhshme të parasë ose vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e interesave të tregut. Risku krijohet fillimisht nga portofoli i letrave me vlerë, si edhe aktiviteti bankar i lidhur me korporatat dhe individët. Risku i normave të interesit menaxhohet kryesisht nëpërmjet monitorimit periodik të diferencave e shumave të normave të interesit midis aktiveve dhe detyrimeve të Bankës si dhe duke përgatitur skenarë analizash mbi normat e interesit për qëllime vendimmarrjeje.

Metoda e përdorur për llogaritjen e riskut te normës së interesit të bilancit të Bankës është analiza e ndjeshmërisë. Analiza e zhvendosjes së ndjeshmërisë saktëson ndryshimin në vlerë të portofolit financiar që rezulton nga lëvizjet e pafavorshme të normës se interesit. Duke konsideruar riskun e normës së interesit, një lëvizje e pafavorshme përkufizohet si një zhvendosje paralele dhe uniforme e kurbës së normës së interesit prej ± 100 pikësh. Kjo matje thekson efektin e variacioneve në normat e interesit të tregut në portofolin që është përllogaritur pa supozuar ndryshime në të ardhmen në aktivet dhe detyrimet e Bankës. Ndjeshmëria e kapitalit llogaritet duke rivlerësuar portofolin e letrave me vlerë të vendosjes. Aktivet financiare të Bankës dhe detyrimet e saj kanë normë të ndryshueshme interesi ose kanë një datë rëçmimi në më pak se një vit me përjashtim të disa letrave me vlerë jo shqiptare, të cilat kanë një norme kupon midis 2.2- 6.9% për letrat me vlerë në USD (2013: 0.8 – 6.8 %), nga 1.6 - 4.5% për letrat me vlerë në EURO (2013: 1.8 – 7.5%) dhe nga 1 – 5.6% për ato në monedhën GBP (2013: 0.9 – 5.5%).

Risku i normës së interesit gjeneruar nga aktivet dhe detyrimet e Bankës dhe i matur nëpërmjet analizës së ndjeshmërisë sipas zhvendosjes ± 100 pikësh, regjistroi në 2014 një vlerë prej Lek 733 milion (për +100 pikë) në fund të vitit (Dhjetor 2013: Lek 803 milion). Tabela më poshtë tregon ndarjen e monedhave sipas analizës së ndjeshmërisë për fund vitin 2014 dhe 2013.

Ndjeshmëria e zhvendosjes 31 Dhjetor 2014	Rritje në bazë pikësh (b.p.)	Totali	Ndjeshmëria e Fitimit & Humbjes	Ndjeshmëria e Kapitalit
EUR	+100 b.p. / -100 b.p.	(127,930)/59,849	(124,330)/59,316	(3,600)/533
USD	+100 b.p. / -100 b.p.	(339,413)/384,918	(274,653)/321,676	(64,760)/63,242
LEK	+100 b.p. / -100 b.p.	(264,476)/275,241	(264,476)/275,241	
Other (GBP & CHF)	+100 b.p. / -100 b.p.	(9,745)/10,229	1,101/(861)	(10,846)/11,089

Ndjeshmëria e zhvendosjes 31 Dhjetor 2013	Rritje në bazë pikësh (b.p.)	Totali	Ndjeshmëria e Fitimit & Humbjes	Ndjeshmëria e Kapitalit
EUR	+100 b.p. / -100 b.p.	(192,053)/204,844	(192,053)/204,844	-
USD	+100 b.p. / -100 b.p.	(306,974)/349,054	(239,014)/285,386	(67,960)/63,668
LEK	+100 b.p. / -100 b.p.	(290,825)/302,050	(290,825)/302,050	-
Të tjera (GBP & CHF)	+100 b.p. / -100 b.p.	(13,563)/14,258	(338)/393	(12,225)/13,865

Banka Qendrore i kërkoi Bankës përdorimin e një metode të ndryshme për matjen e riskut të normës së interesit, e cila parashikon kryerjen e një monitorimi tremujor të ekspozimit të riskut të interesit ndaj një goditje paralele prej +/- 200 pikë të kurbës së normës së interesit. Për të gjitha kategoritë financiare të aktiveve dhe pasiveve të ndara sipas një normë interesi fikse ose të luhatshme, vlera e tyre aktuale është llogaritur dhe klasifikuar në 14 shporta kohore. Më pas vlera aktuale shumëzohet për këtë qëllim me kohëzgjatjen e vlerësuar të modifikuar të çdo shporte kohore. Limiti për këtë ekspozim është 20% i kapitalit rregullator të Bankës. Për periudhën Dhjetor 2014, Banka ka qenë brenda limitit përkatësisht me ekspozime të riskut ndaj normës së interesit prej 1.73% të kapitalit rregullator të Bankës.

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(d) Risku Operacional

Risku operacional përkufizohet si risk i humbjeve që vijnë nga pamjaftueshmëria ose dështimi i proceseve, burimeve njerëzore dhe sistemeve të brendshme, ose si rezultat i ngjarjeve të jashtme dhe përfshin riskun ligjor, i cili është risku i humbjes për shkak të thyerjes së rregullores dhe ligjeve, detyrimeve kontraktuale ose jo kontraktuale ose konflikteve të tjera; modeli i riskut, përcaktuar si humbja e mundshme që mund të pësoj një subjekt, i cili rezulton nga vendime që bazohen kryesisht në rezultatet e modeleve të brendshme, të shkaktuara nga gabime që kanë ndodhur gjatë zhvillimit, zbatimit ose përdorimit të tyre; Risku i përputhshmërisë rregullative përkufizohet si risku i humbjes që rezultojnë nga penalitetet gjyqësore dhe administrative, humbje financiare të konsiderueshme që vijnë nga shkelja e rregulloreve të detyrueshme për zbatim ose rregulloreve të brendshme; risku i TIK (Teknologjia e informacionit dhe Komunikimit, ose e njohur ndryshe si risku kompjuterik) përkufizohet si risku i humbjeve ekonomike që rezulton nga përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Risku strategjik dhe i reputacionit nuk përfshihen.

Këshilli Drejtues i Bankës aprovoi udhëzimet për një strukturë të përgjithshme të menaxhimit të riskut operacional duke miratuar një politikë dhe një proces organizativ për vlerësimin, menaxhimin dhe kontrollin e riskut operacional.

Komiteti për Menaxhimin e Riskut Operacional (më poshtë referuar KMRO) është përgjegjës për menaxhimin e riskut operacional të Bankës në lidhje me rishikimin e dokumentacionit të administrimit të riskut operacional të Bankës dhe miratimin e ndryshimeve, hartimin e politikave, përcaktimin standardeve dhe metodologjive për menaxhimin e riskut operacional. Gjatë vitit 2014, KMRO miratoi 15 tregues të rinj të brendshëm Kryesor të Riskut, krahas 11 Treguesve Kryesor të Riskut të cilët raportohen tashmë pranë Bankës së Shqipërisë dhe politikës së brendshme për Kërkesat e Kapitalit për Riskun Operacional.

Divizioni i Administrimit të Riskut të Bankës është përgjegjës për identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe minimizimin e riskut operacional, verifikimin e efektshmërisë së minimizimit si dhe raportimin tek Drejtuesit e Lartë të Bankës dhe tek Menaxhimi i Riskut të Grupit me synim vlerësimin e impaktit ekonomik të mundshëm veçanërisht nga ngjarje serioze operationale.

Banka ndërmerr një fushatë për vlerësimin vjetor të iniciuar nga Grupi Intesa Sanpaolo, procesin e vetë diagnostikimit, i cili përbëhet nga identifikimi i riskut operacional dhe vlerësimi në lidhje me aktivitetin e një njësie të vetme brenda një strukture.

Objektivat e procesit të vetë diagnostikimit janë të identifikojë, mat, monitorojë dhe zvogëlojë risqet operationale. Procesi i vetë diagnostikimit kontribuon në përhapjen e kulturës për kontrollin e riskut brenda bankës. Ky proces përbëhet nga faza që lidhen me vlerësimin e mjedisit të biznesit, i cili përcakton cilësinë e profilit të kontrollit të riskut të çdo strukture nëpërmjet analizës së rëndësisë dhe nivelit të menaxhimit të faktorëve të riskut në kontekstin operativ dhe fazat që lidhen me Analizën e Skenarit, e cila përcakton madhësinë e profilit të riskut të çdo strukture duke mbledhur të dhëna subjektive nga njësitë përgjegjëse të Biznesit dhe ato Operationale.

Banka ka të njëjtat përgjegjësi dhe kundrejt Bankës Qendrore të Shqipërisë, në lidhje me rregulloren e re të menaxhimit të riskut operacional që ka hyre në fuqi në muajin Janar 2011. Në bazë të saj përgatiten raporte për ekspozimet e treguesve kryesor dhe klasifikimet e humbjeve të realizuara operationale sipas ndarjeve të biznesit në përputhje me kërkesat rregullatore.

4. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(d) Risku Operacional (vazhdim)

Kapitali Rregullator

Rregullatori drejtues i Bankës, Banka Qendrore, vendos dhe monitoron kërkesën për kapital të Bankës. Politika e Bankës është të mbaje bazën e kapitalit brenda limiteve, duke kapitalizuar të gjitha të ardhurat nga aktiviteti në mënyrë që të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit duke njohur impaktin aktual të nivelit të kapitalit mbi kthimet ndaj aksionereve. Banka njih nevojën për të mbajtur një ekuilibër midis kthimeve me të larta që mund të jenë të mundura duke përdorur me shume instrumente dhe avantazhe që ofrohen nga një pozicion i fortë i kapitalit.

Në 18.12.2014, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi rregulloren “Për kapitalin rregullator”, e cila do të hyjë në fuqi në 31 Mars 2015. Banka beson se nisur nga raportimi i mbikëqyrjes financiare që zbatohet aktualisht, rregullorja e re për Kapitalin rregullator nuk do të ketë ndikim në kapitalin rregullator të Bankës.

Norma e Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Në implementimin e kërkesave aktuale për kapital, Banka e Shqipërisë i kërkon Bankës të mbajë një normë të detyrueshme që llogaritet si raport i totalit të kapitalit rregullator ndaj totalit të aktiveve të ponderuara me riskun si dhe zërave jashtë bilancit, në një minimum prej 12%. Gjatë vitit financiar 2014 Banka ka pasur një normë mjaftueshmërie kapitali përtej minimumit të kërkuar dhe në 31 Dhjetor 2014 shënoi një nivel prej 18.2 % (2013: 21%).

Norma e modifikuar e mjaftueshmërisë së kapitalit, e cila përfaqëson normën e kapitalit bazë ndaj aktiveve të vlerësuara me riskun dhe zërave jashtë bilancit që është një tjetër limit i vendosur nga autoriteti mbikëqyrës i Bankës, në një përqindje prej 6%. Edhe kjo normë, gjatë vitit 2014 ka ndjekur trendin e normës më sipër, duke shënuar nivele më të larta krahasuar me limitin rregullator, dhe në 31 Dhjetor 2014 shënoi një nivel prej 18.2% (2013: 21%).

Gjate gjithë periudhës nuk ka pasur ndryshime të konsiderueshme në menaxhimin e kapitalit nga Banka si dhe është siguruar një përputhshmëri me të gjitha kërkesat e jashtme rregullative mbi kapitalin.

Sipas rregullores së re, Norma e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (NMK) llogaritet në bazë të kritereve të Bazel II dhe është në përputhje me Direktivat Europiane për Institucionet Financiare, duke rezultuar në një normë më të ulët. Megjithatë duke u nisur nga kapitali i Bankës, drejtimi vlerëson se Banka do të vazhdojë të mbaj RMK mbi nivelin e kërkuar.

5. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykimet, çmuarjet dhe supozimet të cilat prekin zbatimin e politikave kontabël dhe vlerat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet në fjalë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën gjatë të cilës rishikohen çmuarjet si dhe në periudha të tjera në të ardhmen.

Drejtimi diskuton me Drejtimin e Grupit zhvillimin, përzgjedhjen dhe prezantimin e politikave të rëndësishme kontabël dhe zbatimin e tyre, si dhe supozimet e bëra në lidhje me pasiguritë kryesore të çmuarjeve. Informacioni në lidhje me supozimet dhe pasiguritë e çmuarjeve të cilat kanë një risk të konsiderueshëm të cilat sjellin një rregullim material brenda periudhës financiare të radhës dhe rreth gjykimeve të rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të madh tek shumata e njohura në pasqyrat financiare paraqitet më poshtë. Këto shënime plotësojnë komentet për administrimin e rrezikut financiar (shikoni shënimin 4).

5. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël (vazhdim)

(a) Humbjet nga zhvlerësimet për huatë dhe paradhëniet

Banka rishikon dhe analizon huatë dhe paradhëniet individualisht të rëndësishme në çdo datë të hartimit të pasqyrës së gjendjes financiare për të vlerësuar nëse humbjet nga zhvlerësimi duhet të regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave. Në mënyrë të veçantë, gjykimi nga drejtimi është i nevojshëm për vlerësimin e shumës dhe kohën e rrjedhjes së ardhshme të parasë kur përcaktohen humbjet nga zhvlerësimi. Në përlllogaritjen e fluksit të parasë, banka gjykon situatën financiare të huamarrësit dhe vlerën neto të realizueshme të kolateralit. Këto çmuarje bazohen në supozime lidhur me disa faktorë dhe rezultatet aktuale mund të ndryshojnë, duke sjelle ndryshime të ardhshme në zbritjet nga huatë. Huatë dhe paradhëniet e vlerësuara në mënyrë individuale dhe rezultuar të pazhvlerësueshme, si dhe të gjitha huatë dhe paradhëniet individuale jo të konsiderueshme vlerësohen kolektivisht, në grupe aktivesh me karakteristika të ngjashme risku, për të përcaktuar nëse duhen krijuar provigjione për shkak të ngjarjeve të humbjeve për të cilat ekziston prove evidente, por efektet ende nuk janë të dukshme. Vlerësimi kolektiv merr në konsiderate të dhënat nga portofoli i huave (si cilësia e kredisë, ditët e vonesave, përdorimi i kredisë, etj.) dhe përqendrimet e tjera të riskut dhe të dhënave ekonomike. Humbjet nga zhvlerësimi për huatë dhe paradhëniet paraqiten në mënyrë të detajuar në shënimin 11.

(b) Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Në rastet kur vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare, e regjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar, nuk mund të përfitohet nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur disa teknika të ndryshme vlerësimi të cilat përfshijnë dhe përdorimin e modeleve matematikore. Të dhënat që përdoren në këto modele janë të dhënat që vëzhgohen në treg, dhe kur këto të dhëna nuk janë të disponueshme, nëpërmjet gjykimit përcaktohen vlerat e drejta. Për instrumentet financiare që nuk tregtohen shpesh dhe kanë transparence të kufizuar për çmimin, vlera e drejtë është më pak objektive dhe nevojiten nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimet, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozime çmimi dhe risqe të tjera që prekin instrumentin e caktuar. Vlerësimi i instrumenteve financiare paraqitet në mënyrë të detajuar në shënimin 6.

Banka përdor hierarkinë e mëposhtme për përcaktimin dhe pasqyrimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare nëpërmjet teknikës së vlerësimit:

Niveli 1: çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për aktive dhe pasive identike;

Niveli 2: teknika të tjera, për të cilat të gjitha regjistrimet që kanë një impakt të konsiderueshëm në vlerën e drejtë të regjistruar, janë të vëzhgueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo; dhe

Niveli 3: teknikat që përdorin regjistrime të cilat kanë një impakt të konsiderueshëm në vlerën e drejtë të regjistruar, të cilat nuk bazohen në të dhënat e vëzhgueshme të tregut.

5. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël (vazhdim)

(b) Vlera e drejtë e instrumenteve financiare (vazhdim)

Analiza e instrumenteve financiare të regjistruara me vlerën e drejtë sipas nivelit hierarkik paraqitet si më poshtë:

31 Dhjetor 2014	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Investime financiare-Letra me vlerë të vendosjes				
Investime të kuotuar				
Letra me vlerë të qeverisë	435,420	-	-	435,420
Letra të tjera me vlerë të borxhit	1,671,109	1,818,483	-	3,489,592
Investime të pakuotuar	-	44,531	-	44,531
Totali	2,106,529	1,863,014	-	3,969,543

31 Dhjetor 2013	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Investime financiare-Letra me vlerë të vendosjes				
Investime të kuotuar				
Letra me vlerë të Qeverisë	391,530	-	-	391,530
Letra të tjera me vlerë të borxhit	334,929	1,593,175	-	1,928,104
Investime të pakuotuar	-	43,996	-	43,996
Totali	726,459	1,637,171	-	2,363,630

(c) Të drejta tatimore të shtyra

Të drejtat tatimore të shtyra të cilat rezultojnë nga humbjet nga tatimet dhe diferencat e përkohshme, njihen si aktive nëse ekzistojnë gjasat që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë i mjaftueshëm për të lejuar fitimin nga humbjet që të realizohet. Gjykimi është i nevojshëm për të përcaktuar shumën e të drejtave të tatimit të shtyrë që mund të njihet, në bazë të kohës dhe nivelit të ardhshëm të fitimit të tatueshëm dhe strategjive të ardhshme të planifikimit tatimor. Për më shumë detaje referojuni shënimit 3 (g) dhe 17.

6. Aktivët dhe Detyrimet Financiare

Klasifikimi kontabël dhe vlerat e drejta:

	Shënim	Letra të Investimit	Hua dhe të arkëtueshme	Letra të vendosjes	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera totale kontabël	Vlera e drejtë
31 Dhjetor 2014							
Mjete monetare dhe të ngjashme	7	-	15,890,476	-	-	15,890,476	15,890,476
Hua dhe paradhënie bankave	8	-	25,343,535	-	-	25,343,535	25,343,535
Hua dhe paradhënie klientëve	11	-	40,341,394	-	-	40,341,394	40,341,394
Letra me vlerë:							
Matur me vlerën e drejtë	9	-	-	3,969,543	-	3,969,543	3,969,543
Matur me kosto të amortizuar	10	57,309,439	-	-	-	57,309,439	58,442,774
Totali		57,309,439	81,575,405	3,969,543	-	142,854,387	143,987,722
Depozita nga banka	15	-	-	-	5,663,139	5,663,139	5,663,139
Depozita nga klientët	16	-	-	-	121,279,675	121,279,675	121,666,275
Totali		-	-	-	126,942,814	126,942,814	127,329,414

Letrat me vlerë të vendosjes dhe ato të investimit të Qeverisë Shqiptare janë obligacione me norma të ndryshueshme dhe fikse me kupon. Obligacioni me normë të ndryshueshme paraqitet si interesi mesatar i tre ankandëve të fundit të Bonove të Thesarit me maturim 1 vjeçar plus marzhin. Matja e Vlerës së Drejtë të këtyre obligacioneve kryhet nëpërmjet teknikës së modelit të vlerësimit, duke aktualizuar të gjitha flukset e ardhshme të parasë që rezultojnë nga këto instrumente. Pjesa tjetër e letrave me vlerë të vendosjes dhe investimit janë instrumente në monedha të huaja dhe përfaqësojnë obligacione nga Banka dhe Institucione Financiare. Vlera e tyre e drejtë ofrohet nga Agjenci Ndërkombëtare e Klasifikimeve Bloomberg ose State Street në varësi të kujdestarisë së obligacionit. Vetëm për obligacionin ndërkombëtar të Republikës së Austrisë (Euro) dhe Qeverisë Italiane (GBP) është bërë një përjashtim për shkak se çmimet për to nuk janë gjetur nga State Street dhe janë marrë nga Bloomberg.

Huatë dhe paradhëniet klientëve kanë vlerën e tyre kontabël, e cila është gjithashtu dhe vlera e drejtë e tyre pasi i gjithë portofoli bazohet në norma të ndryshueshme interesi dhe që ri-çmohen në baza tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore. Vlera e drejtë e depozitave nga klientët ri-çmohet duke përdorur vlerën aktuale neto. Normat e interesave të përdorur janë normat e interesit të tregut, të cilat janë të publikuara nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Këto norma janë një përfaqësim i normave të tregut (referojuni shënimit 4 mbi Përmbledhjen e Politikave Kontabël për matjen e vlerës së drejtë). Vlera e drejtë e llogarive rrjedhëse dhe llogarive të kursimit konsiderohet t'i përfaqësohet vlerës kontabël.

6. Aktivet dhe Detyrimet Financiare (vazhdim)

	Shënim	Letra të Investimit	Hua dhe të arkëtueshme	Letra të vendosjes	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera totale kontabël	Vlera e drejtë
31 Dhjetor 2013							
Mjete monetare dhe të ngjashme	7	-	12,466,255	-	-	12,466,255	12,466,255
Hua dhe paradhënie bankave	8	-	21,027,977	-	-	21,027,977	21,027,977
Hua dhe paradhënie klientëve	11	-	43,431,410	-	-	43,431,410	43,431,410
Letra me vlerë:							
Matur me vlerën e drejtë	9	-	-	2,363,630	-	2,363,630	2,363,630
Matur me kosto të amortizuar	10	56,162,536	-	-	-	56,162,536	58,137,169
Totali		56,162,536	76,925,642	2,363,630	-	135,451,808	137,426,441
Depozita nga banka	15	-	-	-	5,264,048	5,264,048	5,264,048
Depozita nga klientë	16	-	-	-	114,700,816	114,700,816	115,548,646
Totali		-	-	-	119,964,864	119,964,864	120,812,724

7. Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjetet monetare dhe të ngjashme për periudhat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Arka	1,000,016	1,385,413
Llogari në banka	8,843,780	3,409,358
Llogari të pakufizuara me bankën qendrore	82,484	3,167
Depozita me banka	5,964,196	7,668,317
Totali	15,890,476	12,466,255

8. Hua dhe paradhënie bankave

Hua dhe paradhënie bankave më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Rezervë e detyrueshme	11,097,753	10,631,176
Depozita në banka korrespondente	14,245,782	10,396,801
Totali	25,343,535	21,027,977

9. Letra me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Qeveria Shqiptare	44,532	43,996
Kompani te listuara:	2,106,529	726,459
-Banka & institucione financiare	937,255	334,929
-Qeveri të BE-së	1,169,274	391,530
Kompani jo te listuara:	1,818,482	1,593,175
-Banka & institucione financiare	1,818,482	1,593,175
Totali	3,969,543	2,363,630

Banka rishikon instrumentet e saj të borxhit të klasifikuara si letra me vlerë të vendosjes në çdo datë bilanci në mënyrë që të vlerësojë nëse ka ndonjë provë objektive që ato mund të jenë zhvlerësuar.

10. Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimit më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Qeveri të huaja dhe të tjera:	4,304,722	4,717,338
-Qeveri të SHBA-së dhe BE-së	4,304,722	4,717,338
Kompani të listuara: Banka	809,288	1,801,571
Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare	52,195,429	49,643,627
Totali	57,309,439	56,162,536

Në 31 Dhjetor 2014, letrat me vlerë të investimit në shumën Lek 2,000,000 mijë (2013: Lek 2,080,000 mijë) janë vendosur si kolateral kundrejt marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes. Këto marrëveshje janë nënshkruar në bazë të kushteve të përgjithshme tipike për kreditimin standard, aktivitetet e huamarrjes dhe kreditimit të letrave me vlerë si dhe në bazë të kërkesave të përcaktuara nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Më 31 Dhjetor 2014, interesi mesatar i letrave me vlerë të investimit të cilat janë vendosur si kolateral për marrëveshjet e anasjellta të riblerjes është 3.78% (2013: 5.60%).

11. Hua dhe paradhënie klientëve

Hua dhe paradhënie klientëve përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Hua klientëve	28,858,135	30,481,459
Paradhënie (overdraft) klientëve	18,409,840	20,501,865
Komisione disbursimit të shtyra	(79,738)	(71,225)
Vlera Bruto	47,188,237	50,912,099
Zbritje nga zhvlerësimi	(6,846,843)	(7,480,687)
Totali	40,341,394	43,431,412

Lëvizjet në zbritjet për humbje zhvlerësimi të huave dhe paradhënieve klientëve paraqiten si më poshtë:

	2014	2013
Zbritjet specifike për humbje nga zhvlerësimi		
Gjendja më 1 Janar	6,973,681	4,494,537
Humbje zhvlerësimi për periudhën		
Shpenzime për periudhën	1,782,851	3,410,247
Rimarrje	(1,165,336)	(754,229)
Diferenca konvertimi	131,436	(37,979)
Shuma të fshira	(1,341,214)	(138,895)
Gjendja më 31 Dhjetor	6,381,418	6,973,681
Zbritjet kolektive për humbje nga zhvlerësimi		
Gjendja më 1 Janar	507,006	657,660
Humbje zhvlerësimi për periudhën		
Shpenzime për periudhën	78,557	4,579
Rimarrje	(123,653)	(156,675)
Diferenca konvertimi	3,515	1,442
Shuma të fshira	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor	465,425	507,006
Totali i zbritjeve për humbje nga zhvlerësimi	6,846,843	7,480,687

12. Ndërtesa dhe Pajisje

Ndërtesa dhe pajisje më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	Toka dhe Ndërtesa	Pajisje informatike dhe elektrike	Mobilie dhe Vepra arti	Mjete të tjera jo elektrike	Paradhënie për pajisje	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 Janar 2013	1,616,616	1,077,108	188,228	288,484	66,281	3,236,717
Shtesa gjatë periudhës	-	114,534	3,900	13,409	98,623	230,466
Pakësime	-	(26,654)	(8,253)	(44,704)	(29)	(79,640)
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	1,616,616	1,164,988	183,875	257,189	164,875	3,387,543
Shtesa gjatë periudhës	15,154	122,434	7,517	4,970	-	150,075
Pakësime	-	(70,003)	(6,848)	(2,993)	(6,617)	(86,461)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	1,631,770	1,217,419	184,544	259,166	158,258	3,451,157

Pakësimet për periudhën deri në 31 Dhjetor 2014 lidhen kryesisht me procesin normal të nxjerrjes jashtë përdorimit të inventarit. Shtesat për periudhën deri në 31 Dhjetor 2014 rezultojnë kryesisht nga pajisjet e TI. Më 31 Dhjetor 2014 Banka nuk ka asnjë angazhim kontraktor në lidhje me ndërtesat dhe pajisjet dhe nuk ekziston asnjë barrë që të jetë e vendosur mbi ndërtesat dhe pajisjet. Sipas vlerësimit më të fundit Banka ka evidentuar se nuk ekziston asnjë e dhënë që aktivi është zhvlerësuar.

12. Ndërtesa dhe pajisje (vazhdim)

	Toka dhe Ndërtesa	Pajisje informatike e elektrike	Mobilje dhe Vepra arti	Mjete te tjera jo elektrike	Paradhënie për pajisje	Totali
Zhvlerësim i akumuluar						
Gjendja më 1 Janar 2013	572,211	830,090	163,989	254,073	-	1,820,363
Zhvlerësimi për periudhën	80,831	85,016	6,693	16,447	-	188,987
Pakësime	-	(24,268)	(8,018)	(43,987)	-	(76,273)
Gjendja në 31 Dhjetor 2013	653,042	890,838	162,664	226,533	-	1,933,077
Zhvlerësimi për periudhën	81,110	94,425	6,060	10,197	-	191,792
Pakësime	-	(62,568)	(6,681)	(2,900)	-	(72,149)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	734,152	922,695	162,043	233,830	-	2,052,720
Vlera kontabël neto:						
Më 1 Janar 2013	1,044,405	247,018	24,239	34,411	66,281	1,416,354
Më 31 Dhjetor 2013	963,575	274,151	21,210	30,656	164,876	1,454,468
Më 31 Dhjetor 2014	897,618	294,724	22,501	25,336	158,258	1,398,437

Më 31 Dhjetor 2014 aktivet e amortizuara plotësisht përbëjnë një shumë prej Lek 945,917 mijë (2013: Lek 852,799 mijë).

13. Aktive Afatgjata Jo-materiale

Aktivitet afatgjata jo-materiale më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 paraqiten si më poshtë:

	Programe kompjuterike & Licenca	Paradhënie për programe kompjuterike	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 Janar 2013	826,204	70,950	897,154
Blerje	123,259	176,402	299,661
Pakësim	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	949,463	247,352	1,196,815
Blerje	238,691	-	238,691
Pakësim	-	(8,525)	(8,525)
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	1,188,154	238,827	1,426,981
Amortizimi dhe humbjet nga zhvlerësimi			
Gjendja më 1 Janar 2013	652,969	-	652,969
Amortizimi për periudhën	94,630	-	94,630
Pakësim	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	747,599	-	747,599
Amortizimi për periudhën	124,747	-	124,747
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	872,346	-	872,346
Vlera neto kontabël			
Më 1 Janar 2013	173,235	70,950	244,185
Më 31 Dhjetor 2013	201,864	247,352	449,216
Më 31 Dhjetor 2014	315,808	238,827	554,635

Blerjet gjatë vitit 2014 përfaqësojnë investimet për licenca dhe programe kompjuterike, kryesisht në lidhje me përmirësimin e sistemit qendror të bankës. Më 31 Dhjetor 2014 zërat e zhvlerësuar plotësisht përbëjnë një shumë prej Lek 594,201 mijë (2013: Lek 410,134 mijë).

14 Mjete të tjera

Mjetet e tjera në datë 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Inventari	2,111,434	895,358
Debitorë të ndryshëm	204,267	210,742
Transaksione ATM & POS	135,002	18,709
Përmirësime të ambienteve me qira	28,924	28,423
Parapagesa	61,336	44,300
Çeqe për arkëtim	2,037	7,168
Të tjera	99,524	93,552
Totali	2,642,524	1,298,252

Në kategorinë e Inventarit paraqiten pronat e rimarra në zotërim si rezultat i ekzekutimit të garancive të huave me probleme dhe paradhënieve klientëve. Aktivët e marra në zotërim përfshijnë një numër pronash si troje dhe ndërtesa të cilat nuk sjellin të ardhura nga qiraja ose nuk përdoren. Gjatë vitit 2014, banka testoi pronat përkatëse për zhvlerësim dhe përcaktoi vlerën e tyre neto të realizueshme, e cila rezultoi me një amortizim në vlerën Lek 148,680 mijë (2013: Lek 2,750 mijë).

Lëvizjet në zërin e aktiveve të marra në zotërim për periudhën e raportimit vijojnë si më poshtë:

	2014	2013
Në fillim të periudhës	895,358	321,042
Shtesa gjatë periudhës	1,874,261	576,407
Pakësime	(512,606)	(3,363)
Amortizimi i periudhës	(148,680)	(2,750)
Efekti i këmbimit valutor	3,102	4,022
Në fund të periudhës	2,111,434	895,358

Lëvizjet në zërin e përmirësimeve të ambienteve me qira për periudhën e raportimit vijojnë si më poshtë:

	2014	2013
Në fillim të periudhës	28,423	32,484
Shtesa gjatë periudhës	11,623	10,516
Amortizimi i periudhës	(11,122)	(14,577)
Në fund të periudhës	28,924	28,423

15. Detyrime ndaj bankave

Detyrime ndaj bankave më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	1,504	1,026,190
Banka korrespondente		
Llogari rrjedhëse	106,909	423,428
Rezidente	999	2,002
Jo-rezidente	105,910	421,426
Depozita	3,803,097	2,000,720
Rezidente	3,803,097	2,000,720
Jo-rezidente	-	-
Marrëveshje te Riblerjes	1,751,629	1,813,710
Totali	5,663,139	5,264,048

Marrëveshjet e riblerjes më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

31 Dhjetor 2014				
Maturimi	Norma e interesit	Vlera nominale	Interesi i përlogaritur	Vlera kontabël
5-Mar-15	2.29%	433,282	761	434,043
5-Jan-15	2.25%	259,969	449	260,418
12-Mar-15	2.27%	608,476	795	609,271
5-Jan-15	2.25%	447,732	165	447,897
		1,749,459	2,170	1,751,629
31 Dhjetor 2013				
Maturimi	Norma e interesit	Vlera nominale	Interesi i përlogaritur	Vlera kontabël
3-Jan-14	3.25%	415,750	1,000	416,750
16-Jan-14	3.02%	260,308	280	260,588
16-Jan-14	3.03%	262,145	283	262,428
3-Jan-14	3.00%	700,689	346	701,035
23-Jan-14	3.01%	172,823	86	172,909
		1,811,715	1,995	1,813,710

Banka ka vendosur si kolaterale Bono Thesari për një vlerë prej Lek 2,000,000 mijë (2013: Lek 2,080,000 mijë) siç është përshkruar edhe më parë në shënimin 10.

16. Detyrime ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014			31 Dhjetor 2013		
	LEK	Valute	Totali	LEK	Valute	Totali
Llogari rrjedhëse						
<i>Individë</i>	4,202,177	8,269,853	12,472,030	2,780,026	6,182,045	8,962,071
<i>Korporata</i>	11,834,533	16,330,127	28,164,660	8,889,798	13,932,377	22,822,175
	16,036,710	24,599,980	40,636,690	11,669,824	20,114,422	31,784,246
Depozita						
<i>Individë</i>	32,729,196	41,219,520	73,948,716	31,189,836	43,263,137	74,452,973
<i>Korporata</i>	1,081,199	5,613,070	6,694,269	3,017,531	5,446,066	8,463,597
	33,810,395	46,832,590	80,642,985	34,207,367	48,709,203	82,916,570
Totali	49,847,105	71,432,570	121,279,675	45,877,191	68,823,625	114,700,816

Tepricat e detyrimeve ndaj klientëve sipas maturimit dhe llojit të monedhës janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014			31 Dhjetor 2013		
	LEK	Valutë	Totali	LEK	Valutë	Totali
Llogari rrjedhëse	16,036,710	24,599,980	40,636,690	11,669,824	20,114,422	31,784,246
Depozita						
Pa afat	2,336,603	6,840,453	9,177,056	1,718,435	5,385,622	7,104,057
1 mujore	2,710,004	1,826,716	4,536,720	3,499,013	2,789,837	6,288,850
3 mujore	1,287,484	4,209,593	5,497,077	3,010,347	4,332,360	7,342,707
6 mujore	3,726,110	6,209,174	9,935,284	3,488,012	6,382,556	9,870,568
9 mujore	36,088	4,234	40,322	32,369	19,137	51,506
12 mujore	16,975,418	22,108,487	39,083,905	15,293,935	23,657,502	38,951,437
24 mujore	4,842,730	2,531,588	7,374,318	5,974,516	3,156,448	9,130,964
Të tjera	1,895,958	3,102,345	4,998,303	1,190,740	2,985,741	4,176,481
	33,810,395	46,832,590	80,642,985	34,207,367	48,709,203	82,916,570
Totali	49,847,105	71,432,570	121,279,675	45,877,191	68,823,625	114,700,816

16. Detyrime ndaj klientëve (vazhdim)

Për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat, normat vjetore të interesit të publikuara dhe aplikuar për afate të ndryshme paraqiten si më poshtë:

	2014	LEK (%)	USD (%)	EUR (%)
Llogari rrjedhëse dhe depozita pa afat		0.01 – 5.17	0.05 – 3.50	0.001 – 1.14
Depozita me afat – 1 mujore		0.50 – 1.35	0.05 – 0.20	0.05 – 0.20
Depozita me afat – 3 mujore		0.50 – 2.15	0.10 – 0.50	0.10 – 1.00
Depozita me afat – 6 mujore		0.50 – 2.95	0.10 – 0.70	0.10 – 1.20
Depozita me afat – 9 mujore		1.55 – 3.15		0.15 – 1.10
Depozita me afat – 12 mujore		0.50 – 3.15	0.10 – 1.10	0.10 – 1.90
Depozita me afat – 24 mujore		1.95 – 3.60	0.20 – 1.25	0.21 – 2.00
Depozita me afat – 36 mujore		2.30 – 4.57		0.35 – 2.30

	2013	LEK (%)	USD (%)	EUR (%)
Llogari rrjedhëse dhe depozita pa afat		0.25 – 5.17	0.10 – 1.10	0.04 – 2.20
Depozita me afat – 1 mujore		1.35 – 1.75	0.10 – 0.20	0.15 – 0.30
Depozita me afat – 3 mujore		1.00 – 4.15	0.30 – 0.75	0.30 – 2.15
Depozita me afat – 6 mujore		1.20 – 5.20	0.40 – 0.95	0.40 – 2.40
Depozita me afat – 6 mujore		2.40 – 5.50		1.10 – 2.70
Depozita me afat – 12 mujore		1.50 – 6.25	0.50 – 1.45	0.50 – 3.10
Depozita me afat – 24 mujore		3.40 – 7.00	1.15 – 2.00	1.40 – 3.40

Ndryshe nga normat e përgjithshme më sipër, Drejtimi i Bankës ka ofruar edhe kushte preferenciale për klientët shumë të rëndësishëm të Bankës.

Të gjitha depozitat e klientëve individ, në përputhje me Ligjin 8873, datë 29/03/2002 “Për sigurimin e depozitave” janë të siguruar pa kosto për klientin deri në shumën Lekë 2,500,000 (ose shuma ekuivalente në Lek nëse janë në monedhë të huaj) pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD).

17. Tatimi i shtyrë

Njohja e aktiveve dhe detyrimeve tatimore të shtyra i atribuohet sa më poshtë:

	31 Dhjetor 2014			31 Dhjetor 2013		
	Aktive	Detyrime	Neto	Aktive	Detyrime	Neto
Aktive financiare të vendosjes	-	-		-	-	-
Aktive të trupëzuara dhe të patrupëzuara	76,962	-	76,962	75,174	-	75,174
Aktive për tatimin e shtyrë, Neto	76,962	-	76,962	75,174	-	75,174

17. Tatimi i shtyrë (vazhdim)

Lëvizjet e diferencave të përkohshme gjatë vitit janë si më poshtë:

31 Dhjetor 2014	Gjendja në fillim	Njohur në fitim ose humbje	Njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse	Gjendja në fund
Aktive financiare për shitje	-	-	-	-
Aktive të trupëzuara dhe të pa Trupëzuara	75,174	1,788	-	76,962
Totali	75,174	1,788	-	76,962
31 Dhjetor 2013				
Aktive financiare për shitje	150,752	(150,752)	-	-
Aktive të trupëzuara dhe të patrupëzuara	47,821	27,353	-	75,174
Totali	198,573	(123,399)	-	75,174

18. Provizione

Lëvizjet e provizioneve gjatë vitit janë si më poshtë:

	Procedime Ligjore Tatimore	Procedime Ligjore të tjera	Provizione Zëra jashtë Bilanci	Të tjera	Totali
Gjendja në 1 Janar 2014	215,148	280,757	15,861	-	511,766
Provizione të krijuara gjatë vitit	-	10,498	9,513	45,270	65,281
Provizione të përdorura gjatë vitit	(1,706)	(149,801)	(2,253)	-	(153,761)
Efekti i këmbimit valutor	-	8,680	7	-	8,687
Gjendja në 31 Dhjetor 2014	213,442	150,134	23,128	45,470	431,973

19. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Fatura për të mbërritur	560,235	565,163
Kreditorë të ndryshëm	61,523	61,596
Llogari të përkohshme	6,908	27,664
Çeqe bankare të lëshuara dhe pagesa transit	360,639	11,954
Detyrime të tjera tatimore	39,284	33,604
Detyrime ndaj palëve të treta	16,955	13,330
Të ardhura/shpenzime të tjera të përlllogaritura/shtyra	29,853	48,334
Totali	1,075,398	761,645

20. Kapitali aksionar dhe primet

Më poshtë është paraqitur një informacion i detajuar në lidhje me kapitalin aksionar të Bankës dhe primet në 31 Dhjetor 2014:

	Numri i aksioneve (në numër)	Vlera nominale (në Lek)	Primi i paguar (në Lek)	Totali i vlerës së aksioneve (në Lek)
Kapitali Aksionar më 31 Dhjetor 2014	15,581,282	357		5,562,517,674
Primi më 31 Dhjetor 2014			1,107,104	1,383,880,000

Të gjitha aksionet e Bankës kanë të drejta të njëjta; nuk ka preferenca, kufizime apo diferencime të tjera, pavarësisht nga fakti i primeve të paguara nga aksionerët më të mëdhenj.

Struktura e kapitalit aksionar të Bankës më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	Numri i aksioneve (në numër)	Vlera nominale (në Lek)	Totali i vlerës së aksioneve (në Lek)	Pjesëmarrja në % (në %)
Kapitali Aksionar më 31 Dhjetor 2013				
<i>Intesa Sanpaolo S.p.A.</i>	15,364,880	357	5,485,262,160	98.61%
<i>Società Italiana per le Imprese all'Estero S.p.A.</i>	216,402	357	77,255,514	1.39%
Kapitali Aksionar më 31 Dhjetor 2014				
<i>Intesa Sanpaolo S.p.A.</i>	15,581,282	357	5,562,517,674	100%

21. Rezerva ligjore dhe rregullative

Për periudhën deri më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013, rezervat rezultuan si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Rezerva rregullative	1,130,983	1,130,983
Rezerva ligjore	613,632	564,541
Totali	1,744,615	1,695,524

Rezerva rregullative u krijua sipas rregullores nr. 51 së Bankës së Shqipërisë “Për nivelin minimal të kapitalit fillestar për veprimtari të lejuara për bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara”, datë 22 prill 1999. Bankat dhe degët e bankave të huaja krijojnë rezerva prej 1.25% deri në 2% të totalit të aktiveve të ponderuara me risk, duke përvetësuar një të pestën e fitimit pas tatimit dhe përpara shpërndarjes së dividendëve.

Dispozitat e të Drejtës Tregtare parashikon krijimin e rezervave prej 5% të të ardhurave neto të Bankës pas zbritjes së humbjes së akumuluar nga vitet e mëparshme. Ky prag nuk është i detyrueshëm nëse rezervat ekzistuese nuk përbëjnë më pak se një të dhjetën e kapitalit të Bankës.

22. Rezerva të tjera vlerësimi

Zëra të tjerë përmbledhës

Gjendja prej Lek 714,555 mije për të dyja periudhat deri më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 përfaqëson diferencat që rezultuan nga konvertimi i kapitalit aksionar nga USD në LEK. Nga kjo gjendje, shuma prej Lek 297,666 mijë u njoh më 1 Janar 2008 nga bashkimi me ish BIA, si rezultat i të njëjtit ndryshim të monedhës së kapitalit aksionar.

Rezerva për letra me vlerë të vendosjes

Rezervat për letra me vlerë të vendosjes përfaqësojnë ndryshimin e vlerës së drejtë të letrave me vlerë të vendosjes. Ndryshimet neto gjatë vitit financiar më 31 Dhjetor 2014 arritën në Lek 28,593 mijë (2013: Lek 111,600 mijë kryesisht për shkak të transferimit të humbjeve nga zhvlerësimi i disa letrave me vlerë të vendosjes në llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve. Shikoni shënimin 9).

Diferenca rivlerësimi nga kurset e këmbimit

Siç përshkruhet edhe në shënimin 3 (a), rezervat nga kurset e këmbimit përfshijnë kryesisht diferencën që rezulton nga lëvizjet e këmbimeve valutore të rezervës letrave me vlerë të vendosjes. Gjate vitit financiar deri më 31 Dhjetor 2014 lëvizjet arritën vlerën prej Lek 13,942 mijë (2013: Lek 1,066 mijë kryesisht për shkak të transferimit të rezervës së akumuluar nga kurset e këmbimit nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të vendosjes në llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve).

23. Të ardhura nga interesi, neto

	2014	2013
Të ardhura nga interesi		
Hua dhe paradhënie klientëve	2,719,726	3,457,003
Letra me vlerë të investimit	3,594,265	4,099,377
Hua dhe paradhënie bankave	267,372	297,141
Letra me vlerë të vendosjes	106,153	96,032
Totali i të ardhurave nga interesi	6,687,516	7,949,553
Shpenzime interesi		
Depozita me afat	1,863,588	2,612,377
Depozita nga banka	180,395	224,812
Llogari rrjedhëse	189,656	276,561
Borxhi i varur	-	2,439
Totali i shpenzimeve nga interesi	2,233,639	3,116,189
Të ardhura nga interesi, neto	4,453,877	4,833,364

24. Të ardhura nga komisioni, neto

	2014	2013
Shërbime arkëtimesh dhe pagesash	292,251	333,642
Llogari rrjedhëse aktive	208,744	200,936
ATM dhe POS aktive	191,116	160,454
Garanci të dhëna	16,464	10,922
Linja krediti të papërdorura/të likuiduara ne avance	22,088	26,826
Komisione administrimi dhe të tjera	10,679	7,684
Të ardhura nga komisionet	741,342	740,464
ATM dhe POS aktive	124,663	101,611
Shërbime bankare - degë të huaja	10,691	6,941
Shërbim arkëtimesh dhe pagesash	552	545
Garanci të marra	1,141	1,020
Shpenzime nga komisionet	137,047	110,117
Të ardhura nga komisionet, neto	604,295	630,347

Shifrat e mësipërme nuk përfshijnë komisionet e arkëtuara për huatë dhe paradhëniet e klientëve (kosto transaksioni) të cilat konsiderohen si rregullim për vlerën neto kontabël të këtyre aktiveve financiare sipas metodës së normës efektive të interesit.

25. Të ardhura bankare nga tregtueshmëria, neto

	2014	2013
Këmbimi valutor	439,159	367,017
Të tjera	559	216,921
Totali	439,718	583,938

26. Të ardhura / (shpenzime) të tjera operative, neto

	2014	2013
Primi për sigurimin e depozitave (Humbje)/fitim nga shitja e mjeteve të qëndrueshme	219,399	215,492
Rimarrje nga huatë e fshira	(16,008)	(2,940)
Humbje operationale të ndryshme, neto	(1,498)	(2,193)
	42,694	3,549
Totali	244,587	213,908

27. Shpenzime personeli

	2014	2013
Paga	833,855	797,630
Personel i transferuar	81,913	83,438
Sigurime shoqërore	91,670	80,654
Trajnime dhe të ngjashme	12,000	21,126
Fonde shpërblimi në përfundim të marrëdhënies së punës	13,988	6,680
Totali	1,033,426	989,528

28. Shpenzime të tjera

	2014	2013
Mirëmbajtje e programeve kompjuterike	152,113	129,567
Telefon dhe energji elektrike	88,403	106,950
Reklama dhe publikime	81,775	144,391
Mirëmbajtje dhe riparime	62,709	61,333
Artikuj kancelarie	67,491	51,642
Shërbime ligjore dhe konsulence	47,552	48,954
Siguria fizike	29,608	29,097
Transportim i vlerave monetare dhe të tjera	31,883	37,942
Udhëtime pune	10,450	6,904
Siguracione	28,487	24,203
Të tjera	13,070	18,001
Totali	613,541	658,984

29. Shpenzime tatimi mbi fitimin

Komponentët e këtij zëri për vitet e mbyllura në 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë:

	2014	2013
Viti aktual	430,666	-
Rregullime për vitet e mëparshme	21	139,083
Shpenzime për vitet e mëparshme	-	(24,900)
Shpenzime për të drejta tatimore afatshkurtra	430,687	114,183
Gjenerimi dhe rimarrja e diferencave të përkohshme	(1,788)	123,399
(Të ardhura)/Shpenzime për të drejta tatimore të shtyra	(1,788)	123,399
Shpenzime të tatimit mbi fitim	428,899	237,582

Gjatë vitit 2013, në vijim të rezultateve kontrollit tatimor të kryer për tatimin mbi fitimin të vitit 2011, Banka njohu tatimin mbi fitimin të vitit të kaluar. Më poshtë paraqitet një kuadrim i shpenzimeve të tatimit mbi fitimin me fitimin kontabël për vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013:

	2014		2013	
Fitimi kontabël përpara tatimit	2,483,816		1,219,399	
Tatimi mbi fitimin sipas normës së tatimit lokal për korporatat	15.00%	372,572	10.00%	121,940
Shpenzime të panjohura	2.34%	58,094	2.28%	27,800
Efekt i tatimor i njohjes së tatimit të viteve të mëparshme	0.00%	21	9.36%	114,183
Gjenerimi dhe rimarrja e diferencave të përkohshme	(0.07%)	(1,788)	(2.24%)	(27,353)
Njohja e detyrimeve tatimore	0.00%	-	0.08%	1,012
Shpenzime të tatimit mbi fitim	17.27%	428,899	19.48%	237,582

Fitimi para tatimit është bazuar ne Ligjin nr. 9228 date 29/04/2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe është llogaritur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit SNRF. Gjithashtu, në bazë të dispozitave të Udhëzimit nr. 5, datë 30/01/2006 për "Tatimin mbi Fitimin", ai është korrigjuar me shpenzime të klasifikuar si të panjohura. Si rezultat i ndryshimit të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", miratuar në datën 28 Dhjetor 2013 dhe në fuqi prej datës 1 Janar 2014, tatimi mbi fitimin për korporatën u rrit nga 10% në 15%.

Gjatë vitit 2013, Banka ka shitur letrat me vlerë të vendosjes të përmendura të cilat ishin zhvlerësuar dhe konsideruar një diferencë e përkohshme me të drejtat tatimore të shtyra si dhe ka konsideruar rimarrjen e zhvlerësimeve si të ardhura të pa tatueshme.

29. Shpenzime tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Shpenzimet e panjohura janë detajuar më poshtë:

	2014	2013
Shpenzime të tatimit mbi fitimin për vitin e mëparshëm	21	139,083
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	37,807	49,807
Humbje të ndryshme operacionale	22,082	6,482
Qira për apartamente	8,820	10,812
Shpenzime për zyra	6,403	10,985
Shpenzime personeli	6,312	6,445
Përfaqësimi	5,257	5,067
Humbje nga huatë dhe paradhënie të parikuperuara	132,956	5,568
Të tjera	22,259	43,748
	145,375	-
Totali	387,292	277,997

Gjatë vitit 2014, Banka ka parapaguar tatim mbi të ardhurat në shumën Lek 131,407 mijë (2013: Lek 262,813 mijë).

30. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara në 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si vijon:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Të drejtat e kushtëzuara	125,539,705	126,143,944
Garanci të marra nga klientët kredimarrës	106,184,219	108,219,611
Garanci të marra nga qeveria	8,245,000	4,200,000
Huadhënie të aprovuara por jo të disbursuara	6,050,526	3,974,300
Letër kredi	829,112	126,603
Transaksione për të ardhmen në tregun e parasë	1,375,000	350,000
Kontrata për këmbime valutore me afat (Forward)	1,846,048	9,273,430
Të tjera	1,009,800	-
Detyrime për angazhimet	5,346,600	4,766,894
Garanci të dhëna në favor të klientëve	5,346,600	4,766,894

Garancitë konsistojnë kryesisht në garanci oferte dhe kontrate. Garancitë dhe letrat e kredisë janë të siguruar nga depozita e mjete monetare. Banka lëshon garanci në favor të klientëve të saj. Këto instrumente mbartin një rrezik kreditimi që është i ngjashëm me atë të kredive të disbursuara.

Të drejtat e kushtëzuara si letrat të kredisë dhe linjat e huas të aprovuara dhe të papërdorura nga klientët janë zëra jashtë bilancit që përfaqësojnë angazhime të ardhshme ku Banka vepron në rolin e përfituesit. Kontratat për këmbime valutore janë zëra jashtë bilancit të cilat përdoren për të kompensuar luhatjet e monedhës dhe si dhe pasqyrimin e efektit në pasqyrën e të ardhurave në datën e maturimit në të cilin ekzekutohet kontrata.

(a) Çështje me autoritetet tatimore

Në vitin 2013, Banka ka një mosmarrëveshje me autoritetet tatimore lidhur me rezultatin e Kontrollit Tatimor për tatimin e fitimit të në 2011. Banka ka një mosmarrëveshje tjetër me autoritetet tatimore lidhur me rezultatin e Kontrollit Tatimor në ish BIA. Banka po ndjek të gjithë hapat ligjore për të mbrojtur veten pasi beson se gjetjet nuk janë në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Rastet janë për momentin në procedura gjyqësore në Gjykatën e Lartë.

Drejtimi i Bankës beson se provizioni për riskun tatimor është i kujdesshëm dhe beson se është përballë një rasti për të cilin ka argumenta të forta.

30. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara (vazhdim)

(b) Procese të tjera gjyqësore

Banka është subjekt procedimesh ligjore, pretendimesh dhe detyrimesh që lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj bankar. Drejtimi beson se të gjitha proceset gjyqësore aktuale ose ato potenciale të së ardhmes nuk do të kenë një efekt material në gjendjen financiare të Bankës, në rezultatet operacionale apo në fluksin e parasë.

31. Angazhime qiraje dhe shpenzime qiraje operacionale

Qiratë operacionale të Bankës më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Më pak se një vit	152,147	148,749
Një deri në pesë vjet	347,504	280,325
Më shumë se pesë vjet	23,466	47,443
Totali	523,117	476,517

Banka ka nënshkruar marrëveshje qiraje me mundësi rinovimi për të gjitha zyrat e saj në Shqipëri. Gjatë vitit 2014, për ambientet e marra me qira, shuma prej Lek 163,839 mijë u njoh si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (2013: Lek 162,421 mijë). Kontratat operacionale të qirasë janë të anulueshme, nëse bëhet një lajmërim paraprak prej 180 ditësh.

32. Palët e lidhura

Palët konsiderohen të lidhura kur një palë ka mundësinë për të kontrolluar palën tjetër ose ushtron një ndikim të konsiderueshëm tek pala tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe vendimeve të tjera operacionale, ose palët kontrollohen nga i njëjti subjekt. Një numër transaksionesh bankare janë kryer me Kompaninë Mëmë Intesa Sanpaolo S.p.A gjatë zhvillimit normal të aktivitetit bankar. Transaksionet e mësipërme përfshijnë hua, depozita dhe të tjera për administratorët, aksionerët dhe palë të tjera të lidhura ngushtë me to. Në shumicën e rasteve, palët e tjera të lidhura janë palë nën kontroll ose interes të aksionerëve të Bankës ose janë familjare të ngushtë të drejtuesve kryesore.

Nuk kanë rezultuar borxhe të dyshimta lidhur me tepicën debitorë të palëve të lidhura, për rrjedhojë as zbritje shtesë për ndonjë humbje zhvlerësimi. Gjatë periudhës së raportimit, nuk ka pasur përfitime afatgjata dhe as shpërblime për përfundim të marrëdhënies së punës të paguara për drejtuesit kryesore. Tepricat e balancave për palët e lidhura më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 vijojnë si më poshtë:

32. Palët e lidhura (vazhdim)

	Kompanitë e Grupit ISP		Drejtuesit kryesor dhe Palë të tjera të lidhura	
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Aktive në fund të vitit	11,325,897	11,045,690	162,327	165,035
Hua e paradhënie institucioneve të kreditit	11,325,897	11,045,690	-	-
Hua e paradhënie klientëve	-	-	162,327	165,035
Detyrime në fund të vitit	76,042	202,545	406,498	208,337
Hua e paradhënie nga institucionet e kreditit	60,438	186,786	-	-
Depozitat e klientëve	4,842	3,056	406,498	208,337
Fatura për të mbërritur	10,762	12,703	-	-
Zëra jashtë bilancit	2,052,245	6,507,159	-	-
Letër Kredi/ Letër Garanci të dhëna	403,787	-	-	-
Letër Kredi/Letër Garanci të marra	791,569	299,147	-	-
Kontrata valutore	856,889	6,208,012	-	-
Kolaterale	-	-	-	-
Të ardhura në fund të vitit	165,474	177,067	5,058	6,264
Të ardhura nga interesi	144,281	171,377	4,488	5,674
Të ardhura nga komisionet	21,193	5,690	570	590
Shpenzime në fund të vitit	89,618	77,044	2,633	4,795
Shpenzime interesi	-	2,439	2,633	4,795
Komisione dhe të tjera	89,618	74,605	-	-
Kompensim për Drejtuesit Kryesor			118,199	157,588
<i>Paga neto</i>			97,633	81,547
<i>Bonuse të paguara neto</i>			-	43,688
<i>Sigurime shoqërore dhe shëndetësore</i>			4,566	2,342
<i>Shpenzime të tjera</i>			16,000	30,011

33. Ngjarjet pas datës së bilancit

Drejtimi i Bankës nuk ka dijeni për ndonjë ngjarje tjetër pas datës së bilancit, të cilat do të kërkonin korrigjime apo edhe shënime shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.